

AASF mbështetet nga BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë



STUDIM PËR SEKTORIN E MISHIT

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e sektorit të mishit, mbi mundësitë kryesore për të financuar këtë sektor.

STUDIM PËR SEKTORIN E MISHIT

Përgatitur nga:

Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)

Prof. Dr. Engjëll Skreli / Prof. Assoc. Dr. Drini Imami

Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive

Tiranë, 2019

AASF Project Office
Rr. Andon Zako Çajupi, No. 7
Tiranë, Albania
Tel: +355 69 294 1513
www.aasf.com.al
Info@aasf.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1. HYRJE	7
2. METODOLOGJIA.....	9
3. TENDENCAT DHE PRESPEKTIVAT E SEKTORIT TË MISHIT	11
3.1. Tendencat e prodhimit.....	11
3.2. Tendencat e tregtisë ndërkombëtare.....	14
3.3. Tregu.....	17
4. STRUKTURA E ZINXHIRIT TË VLERËS DHE AKTORËT KRYESORE	23
4.1. Struktura e zinxhirit të vlerës dhe profili i aktorëve	23
4.2. Flukset në zinxhirin e vlerës dhe koordinimi i zinxhirit.....	29
5. PROCESET E TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT	30
6. ANALIZA SWOT DHE NEVOJAT PËR FINANCIM.....	32
6.1. Strategjia për analizën SWOT	32
6.2. Nevojat për financim	33
7. PËRFUNDIME.....	38
8. BIBLIOGRAFIA	40
9. SHTOJCAT.....	41

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Konsumi total i mishit në BE (kg/frymë).....	18
Figura 2: Konsumi i mishit në Shqipëri dhe në vende dhe rajone të tjera në botë (kg/frymë).....	20
Figura 3: Skema e zinxhirit të vlerës në sektorin e mishit	23

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Ecuria e numrit të gjësë së gjallë 2000-2016	11
Tabela 2: Shpërndarja e prodhimit të mishit të gjedhit sipas qarkut në 2016 (pesha e gjallë)	12
Tabela 3: Shpërndarja e prodhimit të mishit të bagëtive të imëta sipas qarkut në 2016 (pesha e gjallë)..	12
Tabela 4: Shpërndarja e prodhimit të mishit të derrit sipas qarkut në 2016 (pesha e gjallë).....	13
Tabela 5: Shpërndarja e prodhimit të mishit të shpendëve sipas qarkut në 2016 (pesha e gjallë)	13
Tabela 6: Tregtia e jashtme e Shqipërisë në kafshë të gjalla (HS 1)	14
Tabela 7: Tregtia e jashtme e Shqipërisë në mish (HS 2)	14
Tabela 8: Importi i llojeve kryesore të mishit	15
Tabela 9: Tregtia e jashtme e Shqipërisë në sallame dhe produkte të ngjashme (HS 1601)	15
Tabela 10: Importet e gjedhëve të gjallë, 2017.....	15
Tabela 11: Importet e derrave të gjallë, 2017.....	16
Tabela 12: Importet e mishit të ngrirë të gjedhit, 2017	16
Tabela 13: Importet e mishit të shpendëve, 2017	16
Tabela 14: Importet e mishit të derrit, 2017.....	17
Tabela 15: Oferta e mishit të viçit (000 tonë).....	19
Tabela 16: Oferta e mishit të derrit (000 tonë) HS-0203.....	19
Tabela 17: Oferta e mishit të shpendëve (000 tonë) HS-0207	19
Tabela 18: Shpërndarja e fermave me gjedhë qumështi sipas përmasës.....	24
Tabela 19: Shpërndarja e fermave më të mëdha me gjedhë qumështi sipas përmasës.....	25
Tabela 20: Shpërndarja e fermave të mëdha sipas përmasës	25
Tabela 21: Fermat me orientim tregu të mëdha (dele dhe dhi), për 2017	26
Tabela 22: Kalendar i proceseve të prodhimit blegtoral me fokus te gjedhët.....	31
Tabela 23: Kalendar i lindjeve për të imtat dhe gjedhët	31
Tabela 24: Sektori i mishit: Strategjia bazuar në analizën SWOT	32
Tabela 25: Nevojat e financimit për investime	34
Tabela 26: Rajonalizimi i skemave kombëtare të subvencionimit (2018).....	41

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Blegtoria është një sektor agrorshqimor shumë i rëndësishëm në Shqipëri. Mishi është një nga artikujt ushqimorë bazë të shportës së konsumit të familjeve shqiptare. Shporta e konsumit të mishit dominohet dukshëm nga mishi i viçit (ai përbën rreth 1/2 e furnizimit total të mishit për konsum), megjithëse ai është shumë më i shtrenjtë krahasuar me mishin e shpendëve ose të derrit. Kjo është një panoramë krejt e ndryshme nga ajo e BE-së, ku mishi i viçit zë një përqindje shumë më të ulët. Importet zënë një pjesë të konsiderueshme të konsumit lokal për të gjitha llojet e mishit. Zinxhiri i vlerës i mishit konsiderohet si sektor me përparësi duke pasur parasysh potencialin për zëvendësimin e importeve.

Që në fillim të viteve 2000, prodhimi i mishit të gjitha llojeve (i viçit, shpendëve, të imtave dhe derrit) ka pasur një trend rritës. Në përgjithësi, prodhimi i mishit ka si destinacion tregun e brendshëm, kështu që rritja e prodhimit është e nxitur kryesisht nga rritja e kërkesës vendase. Pavarësisht rritjes së prodhimit, importet kanë mbetur të larta, kështu që çdo investim ose zhvillim biznesi do të duhet të konsideronte si përparësi zëvendësimin e importeve, ndërsa eksportet nuk janë premtuese për të ardhmen e afërt (përveç të imtave në kushte të caktuara). Një shqetësim kryesor është mungesa e pajtueshmërisë me standardet, gjë që e pengon Shqipërinë të eksportojë produkte blegtorie (mishi) në tregjet e BE-së.

Objekti i këtij studimi është të japë një panoramë të përgjithshme të sektorit të blegtorisë në Shqipëri duke u fokusuar te mishi, duke analizuar zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale, dhe duke përfshirë mundësitë, kufizimet dhe vështirësitë, me fokus të veçantë në nevojat/potencialet për investime. Ky studim ofron informacione dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për të orientuar strategjitë e hyrjes (ndërhyrjes) për institucionet financiare ose për përgatitjen e produkteve e shërbimeve financiare. Por përdorues potencialë të gjetjeve dhe rekomandimeve të këtij studimi mund të jenë edhe institucionet shtetërore, shoqatat e biznesit, agjencitë e zhvillimit, akademikët dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Ky studim është përgatitur nga ekspertët e Programit të Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF), i cili është një program i financuar dhe zhvilluar nga BERZH-i (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) në bashkëpunim dhe me mbështetje nga qeveria shqiptare, i cili ka nisur aktivitetin në vitin 2016.

Qëllimi i këtij Programi është të motivojë institucionet financiare shqiptare për të mbështetur një sektor vital të ekonomisë shqiptare me potenciale gjerësisht të pashfrytëzuara - bujqësia dhe agrobiznesi. AASF siguron qasje në financa për sektorin e agrobiznesit në dy mënyra: Linjë kredish dhe/ose shpërndarja e riskut të portofolit për institucionet mikrofinanciare (IMF) dhe bankat. Institucionet përfitojnë nga një mbulim i parë i rrezikut të humbjeve që u vu në dispozicion nga Qeveria Shqiptare. AASF përfaqëson një instrument inovativ financiar për të inkurajuar kreditimin nga institucionet financiare në të gjithë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit. Përfituesit përfundimtarë të AASF janë fermerët, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore, prodhimin dhe tregtinë e pajisjeve bujqësore, logjistikën, ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit, tregtarët me shumicë dhe pakicë. Agrobizneset mund të përfitojnë gjithashtu nga programi i Këshillimit të BERZH-it për Biznesin e Vogël (ASB) një program i mbështetur nga BERZH, i cili ofron konsulencë për zhvillimin e strategjisë, marketingut, ristrukturimin teknik dhe fushat tjera të zhvillimit institucional nga ekspertët ndërkombëtarë dhe lokalë.

Për të arritur objektivat e studimit janë përdorur të dhëna dhe informacion nga burime dytësore dhe parësore; intervistat gjysmë të strukturuar me aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit janë përdorur si burim parësor për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë analizuar duke përdorur teknika të ndryshme, ku përfshihen analiza përshkruese, analiza e trendeve (dinamike), analiza e tekstit dhe strategjia bazuar në analizën SWOT. Kombinimi i analizës cilësore dhe sasore ka qenë thelbësor për të identifikuar/kuptuar tendencat, boshllëqet dhe nevojat për investime.

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e sektorit të mishit për mundësitë kryesore për të financuar në këtë sektor. Disa nga mundësitë më të mira për financim në nivel ferme janë investimet për blerjen e kafshëve të racave të përmirësuara (gjedhë, të dhirta, të leshta dhe derra), përmirësimin e kushteve të stallave dhe të ushqimit të kafshëve. Ndonëse investimi për thertore të reja nuk është shumë i nevojshëm, përmirësimi i teknologjisë në thertoret ekzistuese përbën një mundësi për financim. Përmirësimi i një sërë pikash therjeje në mënyrë që ato të përmbushin standardet e sigurisë ushqimore mund të jetë gjithashtu një fushë interesante në rajonet/bashkitë ku ka mangësi thertoresh të licencuara. Mundësi të tjera në lidhje me financimin janë ndërtimi dhe/ose rinovimi i objekteve për ruajtjen e ushqimit të kafshëve, financim për pajisjet e transportit të kafshëve në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian për mirëqenien e kafshëve, përmirësimi i teknologjisë në ndërmarrjet e vogla aktuale të përpunimit të mishit, pajisjet e ruajtjes frigoriferike dhe mjetet frigoriferike të transportit të karkasës dhe produkteve të mishit, investimet për trajtimin e mbetjeve në nivel ferme dhe përpunimi.

Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve të mëdha në rritjen e shpendëve dhe fermerëve të interesuar në rritjen e pulave mund të përbëjë një mundësi të rëndësishme në financimin sipas qasjes së zinxhirit të vlerës.

Kur hartojnë ndërhyrje apo financime investimesh në këtë sektor, institucionet financiare duhet të marrin në konsideratë se (i) mbështetja për investime varet në mënyrë thelbësore nga zhvillimet në zbatimin e standardeve të sigurisë (i cili është një kusht paraprak për investimet e reja në sektorin e blegtorisë – shembulli klasik janë thertoret), dhe se (ii) mund të përdorin bashkëfinancim për investimet: financimi nga banka i kombinuar me mbështetjen financiare publike nëpërmjet skemave mbështetëse të qeverisë shqiptare ose skemave të IPARD. Politika aktuale e granteve të pjesshme ka implikime të rëndësishme për institucionet financiare - ata kanë mundësinë për të bashkëfinancuar investimet për investimin e 100% të shumës, nga e cila 50% mund të jetë kredi afatshkurtër (pjesa që duhet të rimburohet nga granti pas përfundimit të investimit) dhe maksimumi 50% kredi afatgjatë për pjesën që duhet të paguhet nga përfituesi.

1. HYRJE

Bujqësia është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare për sa i përket punësimit dhe kontributit në PBB dhe konsiderohet si sektor me përparësi nga qeveria shqiptare. Pavarësisht rritjes gjatë kohëve të fundit, bujqësia shqiptare ende përballet me sfida të ndryshme, duke përfshirë vështirësinë në aksesin në kredi; sektori bujqësor ka thithur vetëm 2% të totalit të kreditimit të ekonomisë. Blegtoria është sektori agrobiznesi kryesor në Shqipëri, ku përfshihen prodhimi i mishit dhe i produkteve të bulmetit (këto të fundit të analizuara në një raport studimi të veçantë). Që në fillim të viteve 2000, prodhimi i mishit ka pësuar rritje. Në përgjithësi, prodhimi i mishit ka si destinacion tregun e brendshëm, kështu që rritja e prodhimit është e nxitur kryesisht nga rritja e kërkesës vendase. Rreth 1/3 e kërkesës së brendshme plotësohet nga importet (të cilat janë në formën e kafshëve të gjalla dhe mishit të ngrirë) - kështu që investimet në këtë sektor pritet të bëhen me logjikën e zëvendësimit të importeve. Ky studim është përgatitur nga ekspertët e Programit të Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF), i cili është një program i financuar dhe zhvilluar nga BERZH-it (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) në bashkëpunim dhe me mbështetje nga qeveria shqiptare, i cili ka nisur aktivitetin në vitin 2016.

Qëllimi i këtij Programi është të motivojë institucionet financiare shqiptare për të mbështetur një sektor vital të ekonomisë shqiptare me potenciale gjerësisht të pashfrytëzuara - bujqësia dhe agrobizneset. AASF siguron qasje në financa për sektorin e agrobiznesit në dy mënyra: Linjë kredish dhe/ose shpërndarjen e riskut të portofolit për institucionet mikrofinanciare (IMF) dhe bankat. Institucionet përfitojnë nga një mbulim i parë i rrezikut të humbjeve që u vu në dispozicion nga Qeveria Shqiptare. AASF përfaqëson një instrument inovativ financiar për të inkurajuar kreditimin nga institucionet financiare në të gjithë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit.

Përfituesit përfundimtarë të AASF janë fermerët, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore, prodhimin dhe tregtinë e pajisjeve bujqësore, logjistikën, ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit, tregtarët me shumicë si dhe shitësit me pakicë. Agrobizneset mund të përfitojnë gjithashtu nga programi i Këshillit të BERZH-it për Biznesin e Vogël, i cili ofron konsulencë për zhvillimin e strategjisë, marketingut, ristrukturimin teknik dhe fushat tjera të zhvillimit institucional nga ekspertët ndërkombëtarë dhe lokalë.

Objektivat e studimit

Objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është që të japë një panoramë të përgjithshme të zinxhirit të përzgjedhur të vlerës në Shqipëri duke analizuar zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale, dhe duke përfshirë mundësitë, kufizimet dhe vështirësitë, me fokus të veçantë në nevojat/potencialët për investime.

Në mënyrë më specifike, studimi

- ofron një panoramë të përgjithshme të prirjeve kryesore të prodhimit, tendencave të tregtisë ndërkombëtare dhe të tregut;
- ofron një "vështrim të shpejtë" të strukturës së zinxhirit të vlerës, të flukseve dhe administrimit të zinxhirit të vlerës, me fokus të veçantë të "liderët në zinxhirin e vlerës"
- analizon pikat kryesore të zinxhirit të vlerës nëpërmjet një strategjie për analizën SWOT, dhe
- ofron rekomandime për mundësitë kryesore për sistemin bankar (financim për investime, financim për kapital qarkullues dhe financim të zinxhirit të vlerës).

Ky raport studimor ofron informacione dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për të orientuar strategjitë e hyrjes (ndërhyrjeve) për institucionet financiare ose për përgatitjen e shërbimeve financiare.

Metodologjia

Për të përmbushur objektivat e studimit janë përdorur burimet dytësore dhe parësore të informacionit/të dhënave; intervistat gjysmë të strukturuar me aktorë të zinxhirit të vlerës dhe me ekspertë të sektorit janë përdorur si burim parësor për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë analizuar duke përdorur teknika të ndryshme, ku përfshihen analiza përshkruese, analiza e trendeve (dinamike), analiza e tekstit dhe strategjia bazuar në analizën SWOT. Analiza e zinxhirit të vlerës është përdoruesi kornizë e përgjithshme për analizën. Metodologjia përshkruhet më në detaje në seksionin në vijim.

Përdoruesit e synuar

Studimi për zinxhirin e vlerës është hartuar kryesisht për institucionet financiare, por ky studim mund të shërbejë si mbështetje e dobishme dhe në procesin vendimmarrës të aktorëve të tjerë, si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), agjencitë e zhvillimit dhe aktorët e sektorit privat (p.sh. firmat, shoqatat).

Çfarë është dhe çfarë nuk është ky studim

Raporti është një vlerësim i shpejtë dhe, duke marrë në konsideratë burimet dhe kohën e kufizuar në dispozicion, ai trajton në veçanti nevojën për financim në zinxhirin e vlerës dhe për rrjedhje mundësitë për financime nga bankat. Studimi është projektuar në mënyrë të tillë që është i lehtë për t'u lexuar për sa i përket strukturës/rrjedhës logjike dhe nivelit të hollësive të informacionit, duke iu përshtatur nevojave të vendimmarrësve që e lexojnë (p.sh. bankierët). Studimi është projektuar për të shërbyer si "instrument" për stafin ekzekutiv (të bankave) dhe jo si studim kërkimor në vetvete. Raporti nuk është një studim i plotë i sektorit apo një studim i zinxhirit të vlerës që në mënyrë tipike ofron një analizë të detajuar të aktorëve në zinxhirin e vlerës, të shërbimeve mbështetëse (shërbimet e biznesit, shërbimet bankare dhe shërbime të tjera ose shërbime të integruara) dhe mjedisin ekonomik global, kombëtar dhe lokal.

Struktura e raportit

Raporti është strukturuar si më poshtë: seksioni i dytë përmban përshkrimin e metodologjisë. Seksioni i tretë paraqet një analizë të gjerë të tendencave të prodhimit dhe të tregtisë ndërkombëtare. Seksioni katër përshkruan strukturën e zinxhirit të vlerës, flukset dhe profilin e aktorëve. Seksioni pesë jep një panoramë të përgjithshme të proceseve të teknologjisë së prodhimit për ta njohur lexuesin me proceset kryesore teknologjike dhe kostot përkatëse, duke theksuar kohën kur kryhen këto procese (që shpesh reflektohen në shpenzime), si dhe kohën e prodhimit (si tregues për kohën e shitjeve). Seksioni i gjashtë paraqet strategjinë bazuar në analizën SWOT që fokusohet në nevojat/potencialët për investime, ndërsa seksioni në vijim përmban përfundimet dhe rekomandimet.

2. METODOLOGJIA

Përzgjedhja e sektorit

Studimi për zinxhirin e vlerës së mishit është pjesë e një "pakete studimesh sektoriale" për të gjithë sektorët më të rëndësishëm të bujqësisë shqiptare. Për këtë arsye, faza e parë ka konsistuar në përcaktimin e përparësisë së sektorëve ose nënsektorëve apo (grupeve të) produkteve për të cilat ekziston kërkesa/potenciali më i lartë për rritje dhe investime - duke marrë në konsideratë potencialin e tregut për eksport ose potencialin për zëvendësimin e importeve. Dy grupe faktorësh janë marrë në konsideratë gjatë përpilimit të listës së produkteve që do të analizoheshin, përkatësisht potenciali i tregut dhe faktorët e tjerë që mundësojnë avantazhe konkurruese të produktit. Potenciali i tregut është shqyrtuar nga dy këndvështrime: potenciali për eksport dhe potencialet për zëvendësimin e importeve. Potenciali për eksport merr në konsideratë performancën e njohur të eksporteve të kombinuar me kërkesën ndërkombëtare për një produkt të caktuar - kur eksportet rriten me kalimin e kohës dhe kjo përkon me rritjen e kërkesës ndërkombëtare, konsiderohet se ky produkt ka potenciale për eksport. Potencialet për zëvendësimin e importeve shqyrtojnë potencialet për të përmbushur kërkesën vendase. Aspekte të tjera që çojnë në një avantazh konkurrues përfshijnë faktorin e anës së ofertës, si raporti krahasues pune-tokë, tradita dhe aftësitë, si dhe lidhjet e vendosura ndërmjet aktorëve në zinxhirin e vlerës, duke përfshirë gjithashtu lidhjet shumë të mira ndërmjet aktorëve shqiptarë dhe blerësve ndërkombëtarë.

Zinxhiri i vlerës i verës konsiderohet si sektor me përparësi duke pasur parasysh potencialin për zëvendësimin e importeve.

Mbledhja e të dhënave

Ky studim është pjesërisht cilësor dhe pjesërisht sasior. Kjo mundëson që të kuptohet më mirë statusi dhe dinamikat e zinxhirit të produktit përkatës. Studimi kombinon analizën e të dhënave të mbledhura dytësore dhe parësore. Për çështje/tregues të ndryshëm, analiza është bazuar në të dhënat dytësore (duke përfshirë të dhënat sektoriale/struktuore).

Të dhënat dytësore janë marrë nga MBZHR (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), INSTAT (Instituti i Statistikave), UNSTAT COMTRADE (për tregtinë ndërkombëtare), FAOSTAT (për prodhimin dhe konsumin) dhe EUROSTAT (për prodhimin dhe tregtinë ndërkombëtare) etj. Gjithashtu, është kryer një shqyrtim i studimeve dhe raporteve të tjera. Kufizimet e hasura janë se për disa tregues (lidhur me prodhimin vendas dhe tregtinë e brendshme) nuk ka statistika të disponueshme, ndërsa për disa të tjera nuk ka statistika të kohëve të fundit. Megjithatë, për tregtinë ndërkombëtare janë gjetur të dhënat më të fundit që edhe janë analizuar. Ndërkohë, në ato raste kur ka qenë e nevojshme dhe e mundur, janë mbledhur të dhëna nga vende ose (rajone) të tjera për qëllimet e një analize krahasuese.

Mbledhja e të dhënave parësore është realizuar nga intervistat e thelluara gjysmë të strukturuara me persona të mirëinformuar kyç që janë aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit. Për të identifikuar aktorët dhe ekspertët kryesorë për çdo zinxhir vlere për intervistat e gjysmë-struktuara (pjesë e studimit cilësor parësor) u përdor një anketim me teknikë kampionimi "snowball" (ortek bore). Intervistat e thelluara me aktorët kyç të informuar (së bashku me studimet

e dokumentacionit në dispozicion) mundësuan të kuptuarin e përditësuar të modeleve kryesore dhe të hallkave kyçe të zinxhirit të vlerës. Në kontekstin e burimeve dhe kohës së kufizuar në dispozicion, u kryen vetëm një numër i kufizuar intervistash.

Analiza e të dhënave

Në lidhje me analizën e të dhënave/informacioneve, të dhënat statistikore dytësore i janë nënshtruar një analize standarde përshkruese, duke përfshirë tabelat dhe grafikët që tregojnë trendet statistikore apo historike. Është kryer edhe krahasimi i trendeve të prodhimit dhe konsumit me ato në botë, në Evropë dhe në disa raste me vendet fqinje, kur kjo ishte e nevojshme. Për sa i përket intervistave me ekspertë/aktorë të ZV-së, shënimet janë analizuar duke përdorur teknikat e analizës cilësore, me qëllimin për të përmbledhur çështjet më të rëndësishme dhe më interesante të përmendura në intervista. Analiza e zinxhirit të vlerës është përdorur si kuadër i përgjithshëm për analizën e strukturës së zinxhirit të vlerës (produktet, financat dhe informacionet) dhe për analizën e flukseve.

3. TENDENCAT DHE PRESPEKTIVAT E SEKTORIT TË MISHIT

3.1. TENDENCAT E PRODHIMIT

3.1.1. Prodhimi parësor

Prodhimi dhe konsumi i mishit ka shënuar një ulje të fortë në fillim të periudhës së tranzicionit, të pasuar nga një rritje gjatë viteve të mëpasshme. Rritja në prodhimin e mishit u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme, dhe shumë shpejt prodhimi tejkaloi në mënyrë të konsiderueshme nivelet përpara tranzicionit.

Pas një rritje fillestare në fillim të tranzicionit, numri i gjedhëve dhe i të imtave ka rënë që nga viti 2000 (tabela 1), megjithatë, prodhimi i mishit është rritur, si rezultat i investimeve në përmirësimin e racave dhe të menaxhimit (ky i fundit është tipik për fermat e mëdha numri i të cilave është në rritje). Në rastin e shpendëve, prodhimi i brojlerave është katërfishuar gjatë së njëjtës periudhë (shih tabelën 1). Në përgjithësi, prodhimi i mishit ka si destinacion kryesor tregun e brendshëm, kështu që rritja e prodhimit varet nga kërkesa e brendshme.

Tabela 1: Ecuria e numrit të gjësë së gjallë 2000-2016

Kategoria	2000	2005	2010	2014	2015	2016
<i>000 krerë</i>						
Gjedhë	728	655	493	500	504	492
Dele dhe dhi	3,045	2,701	2,581	2,804	2,850	2,911
Derra	103	147	164	172	171	181
Shpendë	5,291	6,432	8,437	9,493	8,558	8,326
<i>000 tonë mish i prodhuar</i>						
Gjedhë	62	68	68	71	71	72
Dele dhe dhi	37	41	44	50	53	51
Derra	10	15	16	18	17	17
Shpendë	4	9	17	17	17	20
Totali	113	133	145	155	158	160

Burimi: INSTAT (2017)

Shpërndarja rajonale

Prodhimi i mishit të gjedhit është më i shpërndarë nëpër qarqe krahasuar me prodhimin e mishit të shpendëve ose të derrit. Megjithatë, ka një prodhim më të lartë në Fier, pasuar nga Elbasani, Korça dhe Vlora, të cilat të gjitha së bashku përbëjnë më shumë se 1/2 e prodhimit total të mishit.

Tabela 2: Shpërndarja e prodhimit të mishit të gjedhit sipas qarkut në 2016 (pesha e gjallë)

Prefektura	Tonë	Përqindja	Kumulative
Fier	13,012	18.0%	18.0%
Elbasan	10,020	13.9%	31.9%
Korçë	7,699	10.7%	42.6%
Vlorë	6,544	9.1%	51.7%
Dibër	5,597	7.8%	59.4%
Kukës	5,141	7.1%	66.6%
Durrës	4,868	6.7%	73.3%
Tiranë	4,868	6.7%	80.1%
Shkodër	4,849	6.7%	86.8%
Berat	4,159	5.8%	92.5%
Lezhë	3,501	4.9%	97.4%
Gjirokastër	1,879	2.6%	100.0%
Totali	72,137	100.0%	

Burimi: INSTAT (2017)

Vlora, Korça dhe Gjirokastra kanë një traditë të konsoliduar në mbarështimin e bagëtive të imëta; vetëm këto qarqe bashkë përbëjnë 42% të prodhimit.

Tabela 3: Shpërndarja e prodhimit të mishit të bagëtive të imëta sipas qarkut në 2016 (pesha e gjallë)

Prefektura	Dele	Dhi	Total RV	Përqindja	Kumulative
Vlorë	7,010	1,216	8,226	16.2%	16.2%
Korçë	5,039	2,005	7,044	13.9%	30.2%
Gjirokastër	4,148	1,880	6,028	11.9%	42.1%
Elbasan	3,561	2,388	5,949	11.7%	53.8%
Fier	4,579	850	5,429	10.7%	64.5%
Berat	2,765	1,287	4,052	8.0%	72.5%
Dibër	2,382	959	3,341	6.6%	79.1%
Shkodër	1,442	1,370	2,812	5.6%	84.7%
Tiranë	1,557	1,074	2,631	5.2%	89.9%
Kukës	1,634	625	2,259	4.5%	94.4%
Durrës	1,028	488	1,516	3.0%	97.4%
Lezhë	527	813	1,340	2.6%	100.0%
Totali	35,672	14,955	50,627	100.0%	

Burimi: INSTAT (2017)

Lezha është tradicionalisht zona kryesore për mbarështimin e derrave; një përqendrim relativisht i lartë i fermave të mbarështimit të derrave vërehet edhe në Shkodër dhe Lushnjë (ku edhe ka qenë ndërmarrja më e madhe mbarështimit të derrave gjatë ekonomisë së planifikuar) - këto tre qarqe përbëjnë afërsisht 77% të prodhimit total të mishit të dërrit.

Tabela 4: Shpërndarja e prodhimit të mishit të dërrit sipas qarkut në 2016 (pesha e gjallë)

Prefektura	Tonë	Përqindja	Kumulative
Lezhë	6,001	34.6%	34.6%
Shkodër	4,408	25.4%	60.1%
Fier	2,954	17.0%	77.1%
Vlorë	1,000	5.8%	82.9%
Durrës	725	4.2%	87.1%
Korçë	706	4.1%	91.1%
Elbasan	497	2.9%	94.0%
Berat	297	1.7%	95.7%
Dibër	294	1.7%	97.4%
Tiranë	212	1.2%	98.6%
Kukës	166	1.0%	99.6%
Gjirokastrë	71	0.4%	100.0%
Totali	17,331	100.0%	

Burimi: INSTAT (2017)

Prodhimi i mishit të shpendëve është më i përqendruar në qarkun e Fierit, i cili përfaqëson më shumë se 1/3 e prodhimit total. Fieri, Vlora, Tirana dhe Berati kontribuojnë me më shumë se 3/4 e prodhimit total të mishit të shpendëve.

Tabela 5: Shpërndarja e prodhimit të mishit të shpendëve sipas qarkut në 2016 (pesha e gjallë)

Prefektura	Tonë	Përqindja	Kumulative
Fier	7,091	36.0%	36.0%
Vlorë	3,000	15.2%	51.2%
Tiranë	2,664	13.5%	64.7%
Berat	2,154	10.9%	75.6%
Elbasan	1,345	6.8%	82.4%
Durrës	777	3.9%	86.3%
Korçë	776	3.9%	90.3%
Shkodër	677	3.4%	93.7%
Dibër	465	2.4%	96.1%
Lezhë	437	2.2%	98.3%
Kukës	179	0.9%	99.2%
Gjirokastrë	159	0.8%	100.0%
Totali	19,724	100.0%	

Burimi: INSTAT (2017)

3.1.2. Përpunimi

Nuk ka statistika të disponueshme për përpunimin e mishit. Megjithatë, vlerësohet se prodhimi i sallamit dhe nënprodukteve të tjera të mishit mund të jetë afërsisht 20 mijë tonë¹.

Një mangësi madhore është trajtimi i mbetjeve nga përpunuesit, tregtarët dhe thertoret; shpesh mbetjet hidhen në landfille të paligjshme duke përbërë një rrezik serioz për ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore. Zbatimi i ligjit për asgjësimin e mbetjeve pritet që të çojë në investime të reja.

3.2. TENDENCAT E TREGTISË NDËRKOMBËTARE

Gjatë viteve të fundit importi i kafshëve të gjalla është ulur pak, ndërsa eksportet janë të papërfillshme (tabela 6). Importi i kafshëve të gjalla përbën 3% të importeve totale të produkteve agrourbushqimore.

Tabela 6: Tregtia e jashtme e Shqipërisë në kafshë të gjalla (HS 1)

Viti	Eksporte '000 USD	Importe '000 USD	Eksport/ Import
2000	31	1,220	2.6%
2005	955	11,168	8.5%
2010	610	34,578	1.8%
2014	742	32,975	2.3%
2015	717	28,223	2.5%
2016	672	23,162	2.9%

Burimi: UNSTAT (2018)

Vërehet se importi i mishit, (kryesisht mishit të ngrirë) ka rënë me më shumë se 20% gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015. Pavarësisht rënies së importit, tregtia e mishit karakterizohet nga një deficit i madh (ndërkohë që eksportet janë të papërfillshme për shkak të kufizimeve në standarde dhe kufizimeve strukturore të sektorit blegtoral). Importi i mishit përbën 5-10% të vlerës së importeve totale të produkteve agrourbushqimore, në varësi të vitit (përgjatë viteve është vërejtur një rritje e peshës).

Tabela 7: Tregtia e jashtme e Shqipërisë në mish (HS 2)

Viti	Eksporte '000 USD	Importe '000 USD	Eksport/ Import
2000	231	18,860	1.2%
2005	337	42,420	0.8%
2010	1,386	70,172	2.0%
2014	658	61,746	1.1%
2015	1,039	57,379	1.8%
2016	1,072	39,272	2.7%

Burimi: UNSTAT (2018)

¹ FAO (2014). Studim për sektorin e mishit

Tabela 8: Importi i llojeve kryesore të mishit

Viti	Mish viçi (HS 0201 dhe 0202)		Mish derri (HS0203)		Mish pule (HS0207)	
	Importe 000 USD	Importe tonë	Importe 000 USD	Importe tonë	Importe 000 USD	Importe tonë
2000	1,195	1,250	6,475	8,444	6,475	8,444
2005	6,800	5,669	12,600	11,401	12,600	11,401
2010	5,796	2,558	19,943	10,352	19,943	10,352
2014	1,598	692	9,738	5,020	9,738	5,020
2015	2,205	1,029	10,932	5,847	10,932	5,847
2016	1,787	997	9,776	5,781	9,776	5,781

Burimi: UNSTAT (2018)

Importi i mishit të përpunuar është i papërfillshëm krahasuar me importin e mishit dhe kafshëve të gjalla - siç u përmend më lart, industria e përpunimit të mishit në Shqipëri ka treguar se është konkurruese në tregun e brendshëm. Edhe eksportet për këtë kategori produktesh janë të papërfillshme.

Tabela 9: Tregtia e jashtme e Shqipërisë në sallameve dhe produkteve të ngjashme (HS 1601)

Viti	Fluksi tregtar	Tonë	Milionë USD
2005	Importi	512.7	0.9
2010	Importi	1,340.6	3.9
2014	Importi	472.2	2.2
2015	Importi	848.2	2.8
2016	Importi	933.4	2.8

Burimi: UNSTAT (2018)

Tregtia e jashtme sipas vendeve partnere

Importet e gjedhëve të gjallë janë të shpërndarë gjatë gjithë vitit, por zakonisht ato priren të jenë pak më të larta gjatë verës. Shumica e importeve vijnë nga Rumania dhe Bullgaria, megjithatë, struktura e importeve ndryshon nga muaji në muaj.

Tabela 10: Importet e gjedhëve të gjallë, 2017

	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Sasia (tonë)	194	343	364	334	278	537	384	548	409	435	393	444
Vlera (000 Euro)	430	905	1,035	873	520	1,403	1,031	1,009	758	804	718	824
Çmimi (Euro/kg)	2.22	2.64	2.84	2.62	1.87	2.61	2.69	1.84	1.85	1.85	1.83	1.85
Struktura e importeve sipas shteteve												
Rumani	60%	54%	46%	55%	56%	22%	26%	35%	19%	20%	9%	19%
Bullgari					18%	25%	22%	30%	60%	53%	56%	41%
IRJM	23%	20%	22%	20%	26%	22%	27%	34%	20%	28%	35%	35%

Burimi: EUROSTAT (2018)

Importet e derrave të gjallë janë të shpërndarë gjatë gjithë vitit, por zakonisht ato priren të jenë pak më të larta gjatë verës dhe gjatë muajit dhjetor. Importet e derrave të gjallë dominohen nga Greqia dhe Hungaria. Në vijim paraqitet çmimi mesatar i peshës së gjallë i derrave të importuar.

Tabela 11: Importet e derrave të gjallë, 2017

Derra të gjallë	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Sasia (tonë)	628	674	723	975	853	729	934	1,263	840	875	764	1,148
Vlera (000 Euro)	854	905	965	1,306	1,196	994	1,318	1,740	1,171	1,196	1,043	1,566
Çmimi (Euro/kg)	136	134	133	134	140	136	141	138	139	137	137	136
Struktura e importeve sipas shteteve												
Greqi	64%	91%	94%	93%	76%	76%	68%	59%	59%	71%	70%	74%
Hungari	6%	9%	6%	7%	18%	24%	31%	26%	34%	27%	23%	22%

Burimi: EUROSTAT (2018)

Importi i mishit të freskët (jo të ngrirë) të gjedhit është i ulët, duke shkuar në disa tonë në muaj - dhe vjen kryesisht nga Holanda. Kështu që mishi i importuar është kryesisht i ngrirë. Importi i mishit të ngrirë të gjedhit shkon rreth 100 tonë në muaj - çmimi mesatar është nën 2 Euro/kg. Mishi i ngrirë i gjedhit vjen kryesisht nga Italia, Polonia dhe Brazili.

Tabela 12: Importet e mishit të ngrirë të gjedhit, 2017

Kategoria	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Sasia (tonë)	60	160	141	123	102	72	127	190	101	85	66	124
Vlera (000 Euro)	94	256	236	183	160	89	169	425	145	103	90	197
Çmimi (Euro/kg)	156	1.61	1.68	1.48	1.57	1.24	1.33	2.23	1.43	1.21	1.36	1.59
Struktura e importeve sipas shteteve												
Itali	34%	35%	58%	62%	28%	67%	55%	14%	50%	40%	61%	50%
Poloni	46%	16%	42%	16%	18%	28%	40%		40%	59%		38%
Brazil		17%		21%	27%			72%				38%

Burimi: EUROSTAT (2018)

Importi i mishit të shpendëve është i konsiderueshëm, duke tejkaluar 2000 tonë/muaj, në pjesën më të madhe të vitit. Importet janë me çmime të ulëta, mesatarisht nën 1 Euro/kg. Mishi i shpendëve importohet kryesisht nga Greqia, Brazili dhe SHBA-ja.

Tabela 13: Importet e mishit të shpendëve, 2017

Mishi i shpendëve	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Sasia (tonë)	1,835	1,940	2,126	1,616	2,253	1,849	2,297	2,086	1,816	1,955	2,314	2,750
Vlera (000 Euro)	1,368	1,585	1,730	1,411	1,846	1,453	2,079	1,862	1,462	1,862	2,191	2,494
Çmimi (Euro/kg)	0.75	0.82	0.81	0.87	0.82	0.79	0.90	0.89	0.80	0.95	0.95	0.91
Struktura e importeve sipas shteteve												
Greqi	11%	30%	32%	26%	18%	20%	17%	21%	21%	17%	18%	18%
Brazil	14%	20%	18%	27%	12%	10%	26%	27%	13%	26%	24%	18%
SHBA	38%	12%	15%	8%	18%	19%	10%	13%	12%	18%	12%	20%
Gjermani	8%	9%	6%	9%	11%	11%	15%	17%	15%	9%	13%	9%

Burimi: EUROSTAT (2018)

Edhe importi i mishit të derrit është i konsiderueshëm - çmimi mesatar është 1,5 Euro/kg. Shumica e mishit të derrit vjen nga Brazili, Kanada dhe SHBA.

Tabela 14: Importet e mishit të derrit, 2017

Mishi i derrit	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Sasia (tonë)	724	558	534	589	785	695	911	1,697	1,179	713	593	623
Vlera (000 Euro)	978	892	756	761	1,202	1,028	1,300	2,338	1,718	1,142	957	856
Çmimi (Euro/kg)	1.35	1.60	1.42	1.29	1.53	1.48	1.43	1.38	1.46	1.60	1.61	1.37
Struktura e importeve sipas shteteve												
Brazil	26%	56%	25%	18%	26%	19%	6%	26%	27%	40%	41%	35%
Kanada	4%						23%	50%	47%	40%	8%	34%
SHBA	24%	5%	5%	9%	25%	36%	44%	4%	4%		12%	4%
Itali	12%	11%	18%	33%	11%	8%	12%	6%	10%	8%	17%	8%
Holandë	17%	12%	25%	27%	16%	15%	7%	7%	5%	3%	7%	10%

Burimi: EUROSTAT (2018)

3.3. TREGU

3.3.1. Tregu ndërkombëtar

Prodhimi ndërkombëtar dhe tendencat e tregtisë, me fokus në BE ²

Konsumi i mishit në botë është rritur gjatë viteve të fundit dhe pritet që të rritet mesatarisht me 1% në vit në periudhën 2017-2030 (një ritëm pak më i ulët krahasuar me vitet e fundit). Tregjet me rritje të rëndësishme janë në Azi, Afrikën Nën-Sahariane dhe Lindjen e Mesme (kryesisht për mishin e shpendëve). Prodhimi i mishit në BE parashikohet që të vazhdojë të rritet, meqenëse kërkesa brenda dhe jashtë BE-së pritet që të rritet.

Prodhimi i mishit të shpendëve në BE po rritet, i nxitur nga tregu i brendshëm. Prodhimi i mishit të derrit pritet të rritet paksa gjatë viteve të ardhshme, por parashikohet një ulje deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e sotshme. Pas ristrukturimit të sektorit të qumështit, prodhimi i mishit të viçit pritet që të kthehet në trendin e tij rënës. Në ndryshim nga sa më lart, prodhimi i mishit të të leshtave dhe të dhirtave ka gjasa që të rritet me 4% deri në vitin 2030, pas disa viteve me rënie.


Fermerët blegtoralë në BE mund të përballen me çmime më të ulëta gjatë viteve që vijnë për shkak të rritjes së konkurrencës, por edhe si rezultat i çmimeve relativisht të ulëta të ushqimit për kafshët - kjo tendencë ka implikime të drejtpërdrejta për fermerët shqiptarë, kostot e prodhimit të të cilëve janë shumë më të larta krahasuar me fermerët në BE.

² Ky seksion bazohet pjesërisht te "EC (2017), EU AGRICULTURAL OUTLOOK FOR THE AGRICULTURAL MARKETS AND INCOME 2017-2030"

Deri në vitin 2030, konsumi për frymë i produkteve të mishit në BE-28 pritet që të stabilizohet ose të pësojë një rënie të lehtë. Megjithatë, duke qenë se rritja e popullsisë përcakton edhe konsumin total të mishit (jo vetëm për frymë), panorama për konsumin e mishit mund të ndryshojë.

Mishi i derrit dhe ai i viçit vazhdon të ndjekë trendin rënës të 10 viteve të fundit në BE, duke i hapur rrugë rritjes së konsumit të mishit të shpendëve. Mishi i të dhirtave dhe të leshtave pritet që të rrisë paksa përqindjen e tij, ndryshe nga tendenca gjatë dekadës së fundit.

Figura 1: Konsumi total i mishit në BE (kg/frymë)



Burimi: EC (2017)

Sipas intervistave me ekspertët, lloji i vetëm i mishit për të cilin Shqipëria ka një potencial për eksport (duke supozuar heqjen e ndalimit të eksporte drejt BE-së) është ai i të imtave, duke marrë në konsideratë edhe rritjen e pritshme të konsumit të mishit të tyre në BE.

3.3.2. Tregu i brendshëm

Shporta e konsumit të mishit në Shqipëri dominohet dukshëm nga mishi i viçit, i cili zë rreth 1/2 e konsumit total të mishit, dhe kjo është një panoramë krejt e ndryshme krahasuar me atë të BE-së, ku konsumi i mishit të viçit zë një përqindje shumë më të ulët të konsumit total të mishit (më pak se 1/5). Konsumi i mishit në BE dominohet dukshëm nga mishi i derrit dhe i pulës - të cilët janë me kosto më të ulët. Konsumi i mishit të të imtave është i papërfillshëm krahasuar me llojet e tjera të mishit (megjithëse, konsumi është më i lartë për konsumatorët shqiptarë sesa konsumatorët e BE-së).

Struktura e ofertës në tregun vendas

Oferta/konsumi i brendshëm i mishit të viçit dominohet nga prodhimi vendas - përqindja e importit është e ulët dhe ka ardhur në rënie.

Tabela 15: Oferta e mishit të viçit (000 tonë)

Kategoria	2005	2010	2015	2016
Prodhimi	63,2	68,0	71,4	72,1
Importi / mish i freskët dhe i ngrirë	5,7	2,6	1,0	1,0
Importi / kafshë të gjalla	5,0	8,7	3,5	1,1
Importi / ekuivalenti i kafshëve të gjalla (të therura)	2,6	4,5	1,8	0,6
Importi total	8,3	7,1	2,8	1,6
Eksporti	:	:	:	:
Oferta	71,5	75,1	74,2	73,7
Importi/ofertë	11,6%	9,5%	3,8%	2,2%

Burimi: INSTAT (2017) për prodhimin, UNSTAT (2018) për tregtinë

Në rastin e mishit të dërrit dhe shpendëve, importet luajnë një rol shumë më të rëndësishëm për të plotësuar kërkesën vendase, po të krahasohet me mishin e viçit.

Tabela 16: Oferta e mishit të dërrit (000 tonë) HS-0203

Kategoria	2005	2010	2015	2016
Prodhimi	9,5	16,0	16,8	17,3
Importi / i freskët dhe i ngrirë	11,4	10,4	5,8	5,8
Importi / kafshë të gjalla	0,003	6,0	9,5	9,5
Importi / ekuivalenti i kafshëve të gjalla	0,002	4,2	6,6	6,6
Importi total	11,4	14,6	12,4	12,4
Eksporti	:	:	:	:
Oferta	20,9	30,6	29,2	29,7
Importi/ofertë	55%	48%	42%	42%

Burimi: INSTAT (2017) për prodhimin, UNSTAT (2018) për tregtinë

Tabela 17: Oferta e mishit të shpendëve (000 tonë) HS-0207


Kategoria	2005	2010	2015	2016
Prodhimi	4,4	17	17,3	19,7
Importi	18,4	20,0	21,4	24,2
Eksporti	:	:	:	0,003
Oferta	22,8	37	38,7	43,9
Importi/ofertë	80,7%	54,1%	55,3%	55,1%
Eksporti/prodhimi	:	:	:	0,02%

Burimi: INSTAT (2017) për prodhimin, UNSTAT (2018) për tregtinë

Kërkesat dhe preferencat e konsumatorit

Pas kalimit në ekonominë e tregut, e cila nisi në fillim të viteve '90, konsumatorët shqiptarë kaluan nga konsumi i ushqimeve kryesisht me bazë drithërash drejt mishit, gjë e cila vinte, nga njëra anë, kryesisht nga rritja e të ardhurave për frymë, dhe nga ana tjetër, nga liberalizimi i tregut. Në fund të viteve 2000 konsumi i mishit për frymë ishte 3 herë më i lartë se gjatë periudhës përpara tranzicionit. Pavarësisht rritjes së konsumit të mishit, ai mbetet ende shumë më i ulët se sa në Evropë dhe BE³.

Figura 2: Konsumi i mishit në Shqipëri dhe në vende dhe rajone të tjera në botë (kg/frymë)



Burimi: FAOSTAT (2018)

Lidhur me preferencat e konsumatorëve, duket se origjina e prodhimit është një faktor i rëndësishëm për shumicën e konsumatorëve shqiptarë. Sipas studimeve të ndryshme për preferencat ushqimore të konsumatorëve në Shqipëri, shumica e konsumatorëve i zgjedhin produktet e tyre bazuar tek origjina (vendase kundrejt importeve). Gjithashtu, brenda grupit të produkteve vendase, ka dallime të konsiderueshme në perceptimet brenda Shqipërisë bazuar në rajonin e prodhimit. Shumica e konsumatorëve e shikojnë rajonin/zonën e origjinës ose si të rëndësishme, ose si shumë të rëndësishme kur vendosin të blejnë produkte ushqimore, përfshirë mishin⁴. Sipas një studimi të mëparshëm⁵, konsumatorët preferojnë mishin e qengjit të vendit dhe për më tepër, mishi i qengjit nga zonat malore preferohet më tepër se mishi nga zonat e ulëta.

3 Zhllima, E., Imami, D., & Merkaj, E. (2012). Food consumer trends in post socialist countries: the case of Albania. *Economia agro-alimentare*.

4 Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., Cela, A., & Sokoli, O. (2015). Consumer preferences for typical local products in Albania. *Economia agro-alimentare*.

5 Imami, D., Chan-Halbrendt, C., Zhang, Q., & Zhllima, E. (2011). Conjoint analysis of consumer preferences for lamb meat in central and southwest urban Albania. *International Food and Agribusiness Management Review*, 14(3).

Ndaj, investimet që rezultojnë në përmirësimin e standardeve të tregtueshmërisë dhe certifikimin territorial përbëjnë një potencial, po të merret në konsideratë preferencat/kërkesa në treg.

Pavarësisht rritjes së konsumit të mishit, ai mbetet ende shumë më i ulët se sa në BE. Hendeku tregon se, meqë të ardhurat e shqiptarëve pritet që të rriten më tej në të ardhmen, konsumi i mishit për frymë ka gjasa të rritet njësoj si për vendet fqinje me të ardhura më të larta.

Standardet e sigurisë

Në të gjithë pjesën e poshtme të zinxhirit të vlerës ka mangësi të standardeve të sigurisë ushqimore. Shqipëria përballet me probleme serioze në sistemin kombëtar të kontrollit të sigurisë ushqimore për sa i përket legjislationit, infrastrukturës, kapaciteteve institucionale, kontrollit dhe zbatimit të ligjit, të cilat ndikojnë në rreziqet reale dhe të perceptuara të sigurisë për konsumatorët. Problemet në sistemin e sigurisë ushqimore janë identifikuar nga disa studime⁶. Standardi i sigurisë ushqimore është një shqetësim kryesor i perceptuar nga konsumatorët shqiptarë. Studime të shumta^{7,8} dokumentojnë/theksojnë shqetësimet e konsumatorëve për sigurinë ushqimore.

Qeveria shqiptare e konsideron sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit si prioritet në politikat e saj në axhendën e përafrimit drejt BE-së. Ligji kryesor për sigurinë ushqimore në Shqipëri është ligji "Për ushqimin", nr. 9863⁹, (datë 28.01.2008). Ai përcakton kërkesat për prodhimin dhe hedhjen në treg të produkteve të sigurta ushqimore për njerëzit dhe të ushqimit për kafshët, deri diku në përputhje me dispozitat e BE-së.

MBZHR ka përcaktuar Standardet Minimale Kombëtare (SMK) në përputhje me praktikën e BE-së. Praktika e mirë bujqësore (PMB) duhet të përkojë me llojin e prodhimit që një fermer duhet të ndjekë në rajonin përkatës, duke përfshirë minimalisht pajtueshmërinë me kërkesat e përgjithshme ligjore për mjedisin. Gjatë viteve të fundit, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve dhe SMK-të janë rishikuar nëpërmjet ndryshimeve ligjore dhe ligjeve të reja, si edhe nëpërmjet Urdhrave të Ministrit të Bujqësisë për këto çështje, siç janë identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve dhe fermave, licencimi i biznesit, grumbullimi dhe transporti i qumështit, shëndeti i kafshëve, etj. Pajtueshmëria me SMK-të është gjithashtu një kërkesë për të pasur akses në disa grante mbështetëse, kryesisht në ato nga IPARD II.

Pavarësisht ndryshimeve ligjore dhe institucionale, shumë fermerë nuk janë të informuar ose të ndërgjegjësuar në lidhje me standardet. Sipas një studimi të mëparshëm¹⁰ shumica e fermerëve nuk e dinë se cilat institucione janë përgjegjëse për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve ose kontrollin e vazhdueshëm të standardeve. Megjithëse shumica e fermerëve deklarojnë se kanë një regjistër të gjësë së gjallë në fermë, ata nuk e dinë se cili është institucioni përgjegjës për kontrollin e tyre. Mungesa e ndërgjegjësimit për standardet çon në papajtueshmëri me këto

6 Verçuni, A., Zhllima, E., Imami, D., Bijo, B., Hamiti, X., & Bicoku, Y. (2016). Analysis of consumer awareness and perceptions about food safety in Tirana, Albania. *Albanian Journal of Agricultural Sciences*, 15(1), 19.

7 Imami, D., Chan-Halbrendt, C., Zhang, Q., & Zhllima, E. (2011). Conjoint analysis of consumer preferences for lamb meat in central and southwest urban Albania. *International Food and Agribusiness Management Review*, 14(3).

8 Zhllima, E., Imami, D., & Canavari, M. (2015). Consumer perceptions of food safety risk: Evidence from a segmentation study in Albania. *Journal of Integrative Agriculture*, 14(6), 1142-1152.

9 I gjithë legjislationi shqiptar (në shqip) mund të gjendet në <http://ligjet.org>.

10 Gjeci, G., Bicoku, Y., & Imami, D., (2016). Awareness about food safety and animal health standards – the case of dairy cattle in Albania. *Bulgarian Journal of Agricultural Science*, 22(2), 339-345.

standarde, gjë që nënkupton qasje më të ulët në treg (veçanërisht në rastin e eksporteve) dhe kufizime në qasje në fonde, qasja në të cilët kushtëzohet nga përmbushja e disa standardeve në mënyrë të dokumentuar (p.sh. IPARD II).


Presioni në rritje nga përafrimi me legjislacionin e BE-së për të përmirësuar standardet, nënkupton kërkesë në rritje për investime të konsiderueshme përgjatë zinxhirit të vlerës për të përmbushur standardet. Fushatat e ndërgjegjësimit të kombinuara me përpjekjet për një zbatim më rigoroz të ligjit dhe disponueshmëria e stimujve financiarë do të rrishte shumë gjasat për t'i rritur këto investime në nivel ferme, tregtari dhe përpunuesi.

4. STRUKTURA E ZINXIRIT TË VLERËS DHE AKTORËT KRYESORE

4.1. STRUKTURA E ZINXIRIT TË VLERËS DHE PROFILI I AKTORËVE

Figura 3 në vijim identifikon në formë skematike aktorët e zinxhirit të vlerës së mishit dhe kanalet kryesore përmes të cilëve mishi qarkullon nga fermerët te konsumatori fundor.

Figura 3: Skema e zinxhirit të vlerës në sektorin e mishit



Burimi: Përgatitur nga vetë autorët

Zinxhiri i vlerës i mishit ka tre kanale kryesore, përkatësisht (i) kanali i mishit të freskët të gjedhëve, deleve, dhive dhe derrit (kanali i parë në figurën 3), (ii) kanali industrial i mishit të shpendëve (kanali i dytë në figurën 2) dhe (iii) kanali i përpunimit industrial të mishit (kanali i tretë në figurën 3). Mishi që prodhohet dhe konsumohet në fermë nuk i nënshtrohet kësaj analize.

Aktorët kryesorë të zinxhirit të vlerës së mishit janë fermerët (e gjedhëve, deleve, dhive dhe derrave), fermerët e mëdhenj të shpendëve, grumbulluesit e mishit (që operojnë kryesisht në kanalin e parë), operatorët e thertoreve, operatorët e pikave të therrjes dhe përpunuesit industrialë të mishit. Në fillim ne kemi paraqitur një profil të shkurtër të aktorëve kryesorë në zinxhirin e vlerës dhe më pas kemi treguar flukset në zinxhirin e vlerës dhe koordinimin e këtij zinxhiri.

Fermerët

Prodhimi i mishit nga gjedhët dhe të imtat nuk është një veprimtari e ndarë - fermerët prodhojnë qumësht dhe mish. Kështu që diskutimi në lidhje me fermerët e prodhimit të qumështit vlen edhe për ata të mishit.

Shumica e fermave me lopë janë shumë të vogla, me vetëm 1 lopë për fermë, kryesisht e orientuar drejt përmbushjes së nevojave për konsum vetjak. Përkatësisht, 59% e fermave me gjedhë kanë vetëm 1 lopë - kështu që shumica e fermave me gjedhë janë ferma që prodhojnë për konsum vetjak. Rreth 1/3 e fermave me gjedhë kanë 2-3 lopë, të cilat mund të konsiderohen ferma që prodhojnë për konsum vetjak dhe shitje. Rreth 8%, ose 13 000 ferma, kanë 5 ose më shumë lopë, mes të cilave 1748 ferma, ose 1% e tyre, kanë 11 lopë ose më shumë; këto ferma kanë një orientim më të fortë drejt tregut dhe një potencial më të fortë për investime në të ardhmen (tabela 18).

Tabela 18: Shpërndarja e fermave me gjedhë qumështi sipas përmasës

	Gjedhë	% ndaj totalit
Numri i fermave		
Kategoria sipas përmasës		
1 kre	94,481	59.2
2 deri në 3 krerë	52,155	32.7
4 deri në 5 krerë	7,756	4.9
6 deri në 10 krerë	3,328	2.1
Mbi 11 krerë	1,748	1.1
Totali	159,468	100
Numri i krerëve		
Kategoria sipas përmasës		
1 kre	94,481	28.8
2 deri në 3 krerë	115,869	35.3
4 deri në 5 krerë	33,273	10.1
6 deri në 10 krerë	24,287	7.4
Mbi 11 krerë	60,187	18.3
Totali	328,097	100

Burimi: INSTAT (2017 - të dhënat e publikuara nga censusi i bujqësisë)

Tabela 19 në vijim paraqet fermat më të mëdha me gjedhë - përkatësisht ato me 21-50 lopë dhe ato me mbi 50 krerë, të cilat mund të konsiderohen ferma të mëdha në kontekstin shqiptar.

Tabela 19: Shpërndarja e fermave më të mëdha me gjedhë qumështi sipas përmasës

Lopët	Numri
21 deri në 50 krerë	213
Mbi 50 krerë (51 e lart)	58
Totali i fermave me lopë me mbi 21 lopë	281

Burimi: Të dhëna të përpunuara të autorit. Të dhënat bruto nga MBZHR

Për sa i përket shpërndarjes në nivel qarku, fermat me orientim tregu gjenden kryesisht në zonat e ulëta dhe perëndimore të Shqipërisë, përkatësisht në Fier, Shkodër, Vlorë dhe Durrës, ku ka edhe një përqendrim përgjithësisht më të madh të të gjitha llojeve të fermave me gjedhë.

Lopët e qumështit mbahen normalisht në stalla të thjeshta, ushqehen kryesisht me foragjere, kulloten në fusha me barë dhe livadhe, dhe u jepet edhe ushqim i koncentruar kafshësh dhe minerale. Në vetëm pak raste, fermat e mëdha kanë investuar në stalla bashkëkohore dhe kanë nisur të zbatojnë kryesisht një regjim të qëndrueshëm prodhimi.

Vetëm disa ferma merren me prodhimin e mishit të gjedhëve si veprimtari e veçantë.

Shumica e njësive të prodhimit të deleve dhe dhive janë gjithashtu shumë të vogla; madhësia mesatare e tufës së deleve është diçka më pak se 30 dele qumështi dhe madhësia mesatare e tufës së dhive është rreth 25 dhi qumështi.

Në Shqipëri ka rreth 40 000 fermerë që mbarështojnë dele dhe 22 000 që mbarështojnë dhi. Tufat me të imta janë shpesh janë të përziera (duke kombinuar të dy llojet). Shumica e fermave me të imta kanë deri në 10 krerë. Përkatësisht, 43% e fermerëve që kanë dele dhe 33% e fermerëve që kanë dhi kanë më shumë se 10 krerë. Në shumicën e rasteve, të imtat rriten në kullota - megjithatë, së fundmi janë raportuar raste të mbarështimit intensiv për disa ferma më të mëdha me dhi.

Tabela 20: Shpërndarja e fermave të të imtave sipas përmasës

Përmasa	Dele	% e totalit	Dhi	% e totalit
	Numri i fermave			
Totali	39,532	100	21,738	100
1 kre	2,065	5	3,717	17
2-3 krerë	6,866	17	5,532	25
4-5 krerë	5,845	15	2,375	11
6-10 krerë	7,912	20	2,845	13
Mbi 10 krerë	16,844	43	7,269	33
Numri i krerëve				
Totali	1,179,540	100	496,102	100
1 kre	2,065	0	3,717	1
2-3 krerë	16,580	1	12,873	3
4-5 krerë	27,163	2	10,837	2
6-10 krerë	65,677	6	23,279	5
Mbi 10 krerë	1,068,055	91	445,396	90

Burimi: INSTAT (2017 - të dhënat e publikuara nga censusi i bujqësisë)

Vetëm 5000 ferma (5% e të gjitha fermave me të imta) janë ferma të konsideruara të mëdha e komerciale (Tabela 21); këto ferma mund të ishin me interes për sistemin bankar. Vlera modale për fermat e mëdha komerciale duket të jetë mes 101 dhe 200 krerë.

Tabela 21: Fermat me orientim tregu të të imtave (dele dhe dhi), për 2017

Kategoritë sipas përmasës	Numri	%
51 deri në 100 krerë	546	10,9
101 deri në 200 krerë	2704	54,0
201 deri në 300 krerë	1506	30,1
Mbi 300 krerë	251	5,0
Totali i fermave të deleve dhe dhive	5007	100,0

Burimi: Të dhënat nga MBZHR të përpunuara nga autorët.

Kështu që në përgjithësi shumica e tufave janë të vogla. Ka disa arsye të përbashkëta për mbizotërimin e tufave të vogla dhe në uljen e numrit të të imtave, përfshirë:

- Vështirësia për të gjetur ushqim, veçanërisht gjatë dimrit;
- Mungesa e kapaciteteve për grumbullimin/përpunimin e qumështit në disa zona. Kjo është më e dukshme në qarkun e Kukësit, ku, pavarësisht sipërfaqes së madhe të kullotave/lëndinave, tufat janë të vogla dhe prodhimi është i ulët;
- Problemet e pronësisë mbi kullotat;
- Mungesa e fuqisë punëtore: të rinjtë kanë emigruar ose nuk duan të punojnë në blegtori;
- Mbarështuesit e të imtave janë kryesisht individë të moshës së mesme ose të moshuar;
- Mungesa e burimeve financiare për të blerë kafshë, ushqim për kafshët, etj., në të gjitha qarqet.

Për sa i përket shpërndarjes në nivel qarku, fermat me orientim tregu të deleve dhe dhive gjenden kryesisht në zonat malore të Shqipërisë, përkatësisht në Gjirokastër, Vlorë, Berat dhe Korçë.

Sistemi i prodhimit është zakonisht i bazuar në kullota. Delet dhe dhitë varen pothuajse plotësisht nga kullotja për t'u ushqyer, si në dimër, ashtu edhe në verë. Në verë ata përdorin edhe tokën bujqësore pas korrjes.

Fermat më të mëdha të të imtave kanë investuar në përmirësimin e stallave dhe shumë prej tyre e prodhojnë vetë ushqimin për kafshët duke kultivuar foragjere dhe drithëra. Rrallë ndodh që majmërimi i qengjave dhe kecave të jetë një veprimtari e ndarë biznesi.

Megjithatë, intensiteti i ulët i përdorimit të kapitalit për prodhim si për fermat e lopëve edhe të të imtave ka rezultuar në prodhimtari të ulët, kosto relativisht të larta prodhimi dhe fitim të ulët, të cilat nuk mundësojnë grumbullimin e kapitalit për investime të reja duke bërë kështu që niveli i prodhimit dhe rendimenti në shumë ferma blegtorale të jetë i ulët.

Fermat e shpendëve. Fermerët e vegjël zakonisht kanë 5-10 pula dhe e rrisin vetë ushqimin për to (p.sh. misër). Pulat zakonisht mbahen në ambiente të vogla ose së bashku me kafshët e tjera të fermës. Prodhimtaria është e ulët dhe vetëm tepricat u shiten konsumatorëve fundorë ose restoranteve në afërsi. Ka më tepër se 40 ferma shpendësh të orientuara drejt prodhimit të mishit. Janë rreth 5-6 ferma të mëdha shpendësh të orientuar drejt prodhimit të mishit (p.sh., Chicken

Farm, Tik-Tik, Driza, Radoshtina, Shehu), me një nivel prodhimi 500 000 pula në vit. Këto janë ferma bashkëkohore dhe kanë mjediset e tyre të thertoreve, ambalazhimit, magazinimit etj. Ekzistojnë rreth 20 ferma me një prodhimtari prej rreth 100 000 pula/vit.

Fermat e derrave. Shumica e fermave të derrave janë të vogla, me një bazë ekstensive mbarështimi. Ka shumë pak ferma të rritjes intensive në Shqipëri, përkatësisht një në Mamurras, një në Fier dhe një në Korçë.

Thertoret dhe pikat e therjes.

Thertoret furnizojnë tregun e brendshëm me mish të freskët, duke qenë se lënda e parë për industrinë e përpunimit kryesisht importohet në formën e mishit të ngrirë. Disa janë me pronësi publike dhe disa të tjera private - kapaciteti i shumicës së tyre nuk shfrytëzohet plotësisht duke qenë se ligji për therjen e kafshëve është i vështirë për t'u zbatuar dhe, gjithsesi, nuk zbatohet rregullisht. Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për të kërkuar therjen e kafshëve në thertore, sipas vlerësimeve të bazuara në intervista, më pak se 20 për qind e gjedhëve theren në thertore, edhe në qarqe e bashki të mëdha si në qarkun e Korçës (ndërsa sipas intervistave, situata është shumë herë më e mirë në bashki të tjera, si ajo e Tiranës).

Thertoret me performancën më të mirë janë thertoret e drejtuara nga përpunuesit dhe tregtarët e mëdhenj (importues), të cilët përpunojnë sasi të mëdha mishi, në kontekstin e biznesit të tyre të tregtimit/përpunimit. Disa nga thertoret janë bashkëkohore - investimet në thertore të reja, ose në modernizimin e atyre ekzistuese (ato që nuk plotësojnë standardet) do të bëhen e interes vetëm kur të ketë zbatim më të fortë të ligjit në lidhje me therjen e kafshëve - në të kundërt, financimi i investimeve të reja pa vendosjen e këtyre kushteve paraprake, nënkupton ekspozim ndaj një rreziku të lartë. Përveç thertoreve, ekzistojnë edhe pika therjeje, të cilat janë mjedise për therje me mjetet bazë të therjes dhe operojnë në kushte higjienike kritike. Ndërkohë që qeveria ka vendosur t'i mbyllë - dhe arriti ta bëjë diçka të tillë për një farë kohe në qytetet kryesore - pikat e therjes janë shumë të përhapura.

Kështu, ekziston potenciali për të kryer investime të reja në modernizimin e thertoreve ekzistuese ose në ndërtimin e të reja, por vetëm me kusht që të zbatohet ligji, i cili është një kusht paraprak për të garantuar shfrytëzimin e duhur të këtyre kapaciteteve.

Përpunuesit e mishit

Industria e përpunimit të mishit në Shqipëri ka qenë sektori i parë agro industrial që u konsolidua dhe tani është pa diskutim segmenti më eficient i zinxhirit të vlerës. Ajo mund të konsiderohet edhe si nënsektori më i avancuar i agroindustrisë. Arsyeja për këtë zhvillim të hershëm ka qenë disponueshmëria e mishit të ngrirë të importuar me çmim të lirë dhe prania e disa importuesve të mëdhenj të pajisur me mjedise të mëdha frigoriferike të ngrirjes së thellë, gjë që ka u mundësuar kompanive të përpunimit të mishit që të mbështeten në një qarkullim të besueshëm të mishit me cilësi të kontrolluar, duke anashkaluar prodhimin vendas të mishit të freskët.

Produktet kryesore të kësaj industrie janë sallamet dhe llojet e tjera të mishit të përpunuar, kryesisht bazuar në mishin e derrit. Megjithatë, përpunohet edhe mishi i shpendëve dhe i viçit. Kompanitë përdorin teknologji bashkëkohore në përpunimin e mishit të ngrirë, por ato përballen me njohuri teknike të kufizuara në përpunimin e mishit të freskët.

Sipas të dhënave të ofruara nga MBZHR, ndodhen të paktën 2 përpunues mishi në qarkun e Durrësit (duke përfshirë kompaninë "Kaziu"), rreth 5 të tilla në Fier, 4 në Korçë (duke përfshirë kompanitë "Fix" dhe "Tona", të cilët janë aktorë të rëndësishëm në nivel kombëtar), 2 në Lezhë (duke përfshirë kompaninë "INCA", e cila është orientuar drejt eksportit), 3 në Shkodër (duke përfshirë kompaninë "Kimca") dhe 6 në Vlorë. Në Tiranë ndodhen dy nga përpunuesit më të mëdhenj të mishit: "EHW" dhe "KMY". Kompanitë lider kanë një dokumentacion të saktë për prodhimin e tyre, duke përfshirë gjurmueshmërinë dhe standardin HACCP të zbatuar. Standardet shqiptare sipas ligjit për ushqimin dhe urdhrave të ministrit të bujqësisë (MBZHR) zbatohen shpesh; madje kompanitë e mëdha zbatojnë edhe standardet e BE-së për higjienën, gjurmueshmërinë dhe HACCP-në. Përpunuesit e mëdhenj si EHW dhe KMY kanë investuar në rjetet e veta të shpërndarjes dhe shitjes me pakicë.

Duket se përpunuesit më të mëdhenj të mishit kanë investuar në teknologji bashkëkohore - kështu, duke marrë në konsideratë edhe mungesën e rritjes së mëtejshme të kërkesës së brendshme, ka pak gjasa që të kenë nevojë për investime për të rritur kapacitetet prodhuese. Si përmbledhje, në sektorin e mishit mund të nevojiten investime nga përpunuesit e vegjël që të përmbushin standardet (për sa i përket modernizimit të mjediseve të prodhimit, linjave të përpunimit dhe ruajtjes së produktit) - megjithatë, ata përballen me konkurrencë të fortë dhe në rritje në tregun lokal, si nga prodhuesit e mëdhenj, ashtu edhe nga importuesit, të cilët kanë avantazhin e formalizimit dhe përmirësimit të kontrollit të standardeve (krahasuar me përpunuesit e vegjël).

Kutia 1: Tona SHPK: përpunues mishi dhe thertore

Hyrje. Tona Company SHPK është një kompani përpunuese e mishit që ndodhet në qytetin e Korçës. Ajo e ka nisur aktivitetin në vitin 1992, pra, që në fillim të tranzicionit. Në vitin 1998 ajo investoi në ndërtimin e një fabrike bashkëkohore në qytetin e Korçës me një sipërfaqe prej 2800 m². Së fundmi ajo ka investuar edhe në një thertore bashkëkohore. Kompania është e përfshirë në importin direkt të gjedhëve dhe derrave të gjallë, të cilët përdoren për shitjen e mishit të freskët dhe për përpunim.

Segmenti i konsumatorëve: Një gamë e gjerë shitësish me pakicë si për mishin e freskët, ashtu edhe për produktet e përpunuara.

Produktet dhe shërbimet: Produktet kryesore janë sallamet dhe proshutat, mishi i paketuar, mishi i konservuar dhe produktet gjysmë të gatshme. Kompania përdor gjithashtu dhe tregton produkte jo mishi, megjithëse mishi (i freskët dhe i përpunuar) është aktiviteti kryesor i saj. Thertorja përdoret kryesisht për nevojat e kompanisë (për kafshët e gjalla të importuara direkt nga shoqëria për nevojat e saj të tregtimit/përpunimit) – shërbimi për palë të treta zë një pjesë të papërfillshme të aktivitetit të kompanisë.

Tregu dhe kanalet: Kompania ka ngritur kanalet e veta të shpërndarjes duke furnizuar direkt dyqanet e vogla dhe zinxhirët e supermarketeve. Kompania ka ngritur kapacitetet e veta logjistike të shpërndarjes (p.sh. transporti frigoriferik). Kompania ka një prani të përhapur në Korçë (një nga qytetet më të mëdha të jugut), por megjithatë produktet e saj gjenden në të gjithë vendin.

Furnizuesit: kompania mbështetet kryesisht në mishin e importuar, ndonëse ajo blen edhe gjedhë nga vendi (në një masë më të vogël). Për të arritur vëllimet e kërkuara dhe gjurmueshmërinë, importi mbetet strategjia kryesore (duke pasur parasysh përmasat e vogla të fermave në Shqipëri).

Burimet: Njësi përpunimi bashkëkohore, thertore bashkëkohore, kapacitete të mira logjistike për transport.

Faktorët e suksesit dhe mësimet e nxjerra: a) cikli i integruar/i mbyllur – kompania importon direkt kafshë të gjalla, gjë që i mundëson efektivitetin (kosto më të ulta) dhe cilësinë (një pjesë e produkteve të saj prodhohen nga mishi i freskët dhe kjo nuk ndodh për shumicën e përpunuesve, të cilët përdorin mishin e ngrirë të importuar), b) zotërimi dhe operimi i një thertoreje pranë fabrikës së përpunimit, gjë që përbën një avantazh për sa i përket kostove të punës, por edhe kontrollit të standardeve, c) zbatimi i standardeve ISO dhe HACCP, d) investimi në shpërndarje dhe marketing, e) përvoja e gjatë në prodhim dhe tregti në këtë biznes (që në fillim të tranzicionit).

Shqetësimi kryesor: investimi në thertoren bashkëkohore përdoret në një shkallë të kufizuar nga palët e treta, duke qenë se thertoret joformale/të paligjshme janë ende shumë të përhapura. Nëse sistemi i kontrollit (veterinar / kontrolli i standardeve) do të funksiononte siç duhet, ky kapacitet do të shfrytëzohej më shumë/më mirë - përveç kësaj, biznesi mund të shfrytëzonte më tepër prodhimin vendas.

4.2. FLUKSET NË ZINXHIRIN E VLERËS DHE KOORDINIMI I ZINXHIRIT

Flukset e produktit, informacionit dhe ato financiare

Flukset e produktit. Zinxhiri i vlerës i mishit ka tre kanale kryesore, përkatësisht (i) kanali i mishit të freskët të gjedhëve, deleve, dhive dhe derrit (kanali i parë në figurën 2), (ii) kanali industrial i mishit të shpendëve (kanali i dytë në figurën 2) dhe (iii) kanali i përpunimit industrial të mishit (kanali i tretë në figurën 3). Mishi që prodhohet dhe konsumohet në fermë nuk i nënshtrohet kësaj analize. Në kanalin e parë, restorantet porosisin kafshë të gjalla, të cilat transportohen drejt thertoreve ose pikave të therjes, nga ku marrin karkasat/mishin. Mishi transportohet ose nga grumbulluesit e mishit të pajisur me mjete transporti, ose nga vetë restorantet. Po kështu, fshatarët ua dorëzojnë kafshët kasapëve, të cilët i transportojnë ato në thertore ose në pikat e therjes, nga ku marrin karkasat. Në kanalin e dytë, pularitë e mëdha e përpunojnë vetë prodhimin e tyre në thertoret e tyre bashkëkohore dhe ia furnizojnë mishin e pulës dyqaneve të mishit, restoranteve dhe dyqaneve të mëdha. Disa pulari të mëdha (rasti i firmës "Driza") kanë nisur një lloj bujqësie mbështetur në marrëdhënie kontraktuale - ato u dërgojnë zogj fermerëve (dhe potencialisht edhe ushqim) dhe u blejnë mbrapsht produktin përfundimtar. Në kanalin e tretë, përpunuesit e mëdhenj e bashkëkohorë të mishit përpunojnë kryesisht mish të importuar dhe rrallë mish të freskët. Disa prej tyre madje kanë edhe thertoret e tyre. Ata përpunojnë një pjesë të mishit (të kafshëve të importuara) dhe pjesën tjetër e shesin të freskët (dyqaneve të mishit/kasapëveose supermarketeve). Mishi i përpunuar shitet nëpërmjet zinxhirëve të tyre të shitjes (p.sh., EHW ose KMY) dhe direkt në zinxhirë të tjerë dyqanesh të shitjes me pakicë ose në dyqane tradicionale.

Flukset financiare. Pagesa për mishin e freskët (të gjedhëve, deleve, dhive dhe derrit) që u shitet shitësve me pakicë bëhen tipikisht me para në dorë. Në rastin e shitjes në dyqanet e mëdha nga pularitë e mëdha ose përpunuesit e mëdhenj të mishit, ka edhe raste të pagesave të mëvonshme. Përpunuesit e mishit shpesh marrin pagesa të mëvonshme nga njësitë e shitjes me pakicë që ata furnizojnë.

Flukset e informacionit. Qarkullimi i informacionit nga aktorët në hallkat e poshtme të zinxhirit drejt fermerëve të gjedhëve dhe të imtave është i rrallë, duke qenë se prodhimi i mishit është shumë rrallë (në mos fare) një aktivitet i veçantë. Pularitë e mëdha kanë filluar të përdorin një lloj organizimi të mbështetur në marrëdhënie kontraktuale duke u siguruar fermerëve teknologjinë e rritjes.

Koordinimi i zinxhirit të vlerës

Në sektorin e pularisë ka nisur të zhvillohet një lloj organizimi i mbështetur në marrëdhënie kontraktuale (siç u përmend më lart). Pularitë e mëdha me thertore bashkëkohore dhe me kapacitet të lartë kanë vendosur marrëdhënie më të qëndrueshme me një numër të kufizuar fermerësh. Ato i furnizojnë fermerët me zogj (dhe potencialisht edhe ushqim) dhe u blejnë sërish produktin e përfunduar (pulën e rritur). Ky lloj organizimi i zinxhirit parashikohet që të jetë e ardhmja e sektorit të pularisë. Me rritjen e sektorit të pularisë, lind nevoja për specializim - një numër i madh operatorësh (duke përfshirë fermerët) merren me rritjen dhe një numër i vogël përpunuesish (thertore) merren me përpunimin dhe tregtimin e mishit. Ndërkaq, duhet pranuar se rritja e shpendëve nga një numër më i madh operatorësh (më të vegjël) motivohet edhe nga shqetësimet për shëndetin e kafshëve dhe cilësia e produktit.

5. PROCESET E TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT

Racat lokale dominojnë dhe i janë përshtatur mirë kushteve lokale. Në Shqipërinë e veriut, racat kryesore të të leshtave janë Ruda, Bardhoka; dhe racat kryesore të të dhirtave janë: Hasi, Capore, Alpine të kryqëzuara me raca të huaja/franceze. Në Shqipërinë e jugut racat kryesore të të leshtave dhe të dhirtave janë racat vendase të kryqëzuara me ato të huaja /franceze.

Mbarështimi i të imtave varet shumë nga aksesimi në kullota - bizneset për mbarështimin intensiv të imtave janë të rralla. Për sa i përket modelit të biznesit, vihet re një ndryshim që ndikohet nga vendndodhja. Për hir të krahasimit, ekziston një strukturë e ndryshme mbarështimi që është më tipike për malësitë ose Shqipërinë e veriut, ku çmimi i qumështit është më i ulët (krahasuar me Shqipërinë jugperëndimore), duke bërë që fitimet të jenë më të mëdha në prodhimin e mishit. Në pjesën jugore të Shqipërisë (p.sh. Gjirokastrë), duke qenë se çmimi i qumështit të deles dhe dhisë është shumë më i lartë se në veri, ka më tepër fitim që qengji (apo keci) të shitet sa më shpejt që të jetë e mundur, me qëllim që të shitet sa më tepër qumësht që të jetë e mundur – megjithatë, edhe në këtë rast, të ardhurat nga shitja e qengjit (keci) ende zë një përqindje të konsiderueshme të të ardhurave (ndonëse sjell më pak të ardhura se shitja e qumështit).

Raca e gjedhëve dominohen nga racat intensive (p.sh. të importuara nga Holanda, Franca dhe Gjermania). Prodhimi nga gjedhët është fokusuar pothuajse ekskluzivisht tek prodhimet e bulmetit - mishi konsiderohet si nënprodukt. Ka shumë pak raste të fermave të gjedhëve të orientuar drejt prodhimit të mishit, por ky orientim nuk është shumë i suksesshëm për shkak të kostos së lartë të prodhimit dhe konkurrencës së fortë nga çmimet më të lira të importeve nga vende më konkurruese.

Prodhimi i mishit të shpendëve dominohet nga bujqësia intensive. Për shpendët, cikli i prodhimit zgjat zakonisht 35-40 ditë, që përkon me një peshë të gjallë rreth 1,7-2 kg (rendimenti është afërsisht 75%). Norma e konvertimit është 1,6 ose 1,7 kg ushqim për kafshët për 1 kg mish peshë e gjallë (llogaritja e normës së konvertimit për të imtat ose gjedhët është më e vështirë për shkak të përzierjes së lartë ose orientimit drejt prodhimit të qumështit).

Për prodhimin intensiv të derrave, norma e konvertimit është afërsisht 1 kg mish peshë e gjallë për çdo 2,6 - 3,3 kg ushqim, megjithatë, duke pasur parasysh që në Shqipëri ka vetëm pak ferma për rritjen intensive të derrave, është e vështirë që të jepen vlerësime mesatare.

Tabela 22 në vijim paraqet një panoramë të përgjithshme të kategorive kryesore të proceseve të prodhimit (që lidhen me shpenzimet përkatëse)përfshi prodhimin e ushqimit për kafshët (p.sh. lopët) dhe shërbime të tjera të lidhura me to.

Tabela 22: Kalendari i proceseve të prodhimit blegtoral me fokus te gjedhët

Muajt												
Llojet kryesore të shpenzimeve	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Prodhimi në fermë i ushqimit për kafshët												
1. Përgatitja e tokës për prodhimin e foragjereve	■										■	■
2. Plehra bazë dhe plotësues	■	■	■	■	■				■			
3. Kullimi i tokës	■	■										■
4. Korrja			■	■	■	■	■	■	■			
Blerja e ushqimit për kafshët												
1. Bagëti në regjim kullosor	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
2. Bagëti në regjim stallor	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Trajtimi mjekësor												
Trajtimi mjekësor, vaksinimi, etj.			■	■	■	■			■	■	■	

Burimi: Vlerësimi i ekspertëve, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit dhe intervistat

Metodat kryesore për të rritur nivelin e produktivitetit të prodhimit blegtoral janë: i) përzgjedhja dhe përmirësimi i racës; ii) zgjedhja e një racioni të balancuar ushqimi në lidhje me nivelin e prodhimit, iii) kushtet e strehimit dhe kujdesi shëndetësor, iv) ushqyerja e përshtatshme dhe në kohë, dhe v) kombinimi i mirë ndërmjet përdorimit të kullotës dhe ushqimit të koncentruar.

Tabela 23 në vijim paraqet një panoramë të përgjithshme të kalendarit të lindjes për të imtat dhe gjedhët. Qengjat dhe kecat zakonisht shiten 3-6 muaj pas lindjes (por kjo varet nga qarku, siç tregohet më lart), ndërsa viçat 3-6 muaj pas lindjes. Ndërsa kalendari i prodhimit të mishit të pulës është i harmonizuar (i kontrollueshëm) përgjatë gjithë vitit.

Tabela 23: Kalendari i lindjeve për të imtat dhe gjedhët

Muaj												
Kalendari i lindjeve	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Delet dhe dhitë		■	■	■								
Lopët			■	■	■							

Shënim: Për lopët në stalla ka një diversifikim.

Burimi: Vlerësimi i ekspertëve, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit dhe intervistat

Mospërputhja kohore mes kostove (që zakonisht janë të shpërndara përgjatë gjithë vitit) dhe të ardhurave që merren në momente të caktuar (p.sh. në kohën kur shiten viçat, qengjat ose kecat, si edhe qumështi) mund të paraqesë një potencial për kredi afatshkurtra.

6. ANALIZA SWOT DHE NEVOJAT PËR FINANCIM

6.1. STRATEGJIA PËR ANALIZËN SWOT

Strategjia e mëposhtme bazuar në analizën SWOT është kryer me qëllim identifikimin e mundësive për financim në sektorin e mishit.

Tabela 24: Sektori i mishit: Strategjia bazuar në analizën SWOT

	PIKAT E FORTA (S) (+)	PIKAT E DOBËTA (W) (-)
	Ekzistenca e racave të përshtatshme (përfshirë ato lokale) për prodhimin e mishit cilësor (gjedhë, derra, shpendë)	Shpesh raca që nuk janë të përshtatshme për prodhimin e mishit – rendimenti i ulët për krerë
	Tendenca pozitive lidhur me përmasën e fermës, numri i konsiderueshëm i fermave të mëdha të shpendëve	
	Krijimi i stallave bashkëkohore (gjedhë, të imta, shpendë)	Shpesh stalla të papërshtatshme ose mungesa e ambienteve për shpendët e rritur në kushte shtëpie
	Shumë ferma të mëdha zotërojnë traktorët dhe e prodhojnë vetë ushqimin për kafshët.	Shpesh nuk ka ushqim të mjaftueshëm për kafshët ose ushqimi ka kosto të larta
	Krijimi i thertoreve bashkëkohore (për shpendët...)	Thertoret në pronësi të bashkive përballen me shpenzime dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme
	Ambientet dhe teknologjia bashkëkohore për përpunimin e mishit të ngrirë	Mjediset dhe pajisjet e vjetruara në pikat e therjes
		Mungesa ose në rastin më të mirë zhvillimi i pamjaftueshëm i fermerëve të nënkontraktuar për rritjen e pulave në shtëpi
		Mungesa e sistemit të trajtimit të mbetjeve (në fermë, thertore dhe përpunimin e mishit)
MUNDËSITË (O) (+)	STRATEGJIA PËR S (+) / O (+)	STRATEGJIA PËR W (-) / O (+)
Kullotat të pasura dhe cilësore për kullotje. Reshjet e mjaftueshme të shiut		
Mundësia e eksportit të mishit të qengjit	Mbështetja për rritjen e numrit të kafshëve, në veçanti për tufat e mëdha	
Politikat e favorshme nga qeveria dhe IPARD		Përmirësimi i thertoreve publike
		Mbështetja për të modernizuar pikat e therjes në zona ku mungojnë thertoret
		Mbështetja për nënkontraktimin në sektorin e pularisë
		Një impiant për grirjen ose djegjen (incinerator) e mbetjeve në vend
KËRCËNIMET (T) (-)	STRATEGJIA PËR S (+) / T (-)	STRATEGJIA PËR W (-) / T (-)
Moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve		
Ulja e potencialit për mishin e dërrit për arsye fetare		
Moszbatimi i ligjit për veterinarinë		

6.2. NEVOJAT PËR FINANCIM

6.2.1. Tendencat për investime dhe nevojat për financim

Vitet e fundit është vënë re ngritja e disa fermave të reja me gjedhë me pajisje bashkëkohore dhe me më shumë se 50 lopë për fermë. Në disa raste, fermerë të rinj futen në sektorin e të imtave duke investuar në blerjen e deleve dhe dhive – janë vënë re disa raste të bizneseve të reja në mbarështimin e të dhirtave që kanë bërë investime të konsiderueshme. Të dhënat tregojnë se ka pasur një rritje të numrit të deleve dhe dhive gjatë viteve të fundit. Fermat e të imtave me tufa më të mëdha kanë investuar gjithashtu në përmirësimin e stallave.

Prodhimi i mishit të freskët nga gjedhët dhe delet e dhitë nuk ekziston si veprimtari më vete në Shqipëri. Intervistat në terren informojnë se në Shqipëri ka pasur vetëm disa prodhues të mishit të gjedhëve, por jo shumë të suksesshëm. Gjithashtu, prodhimi i mishit nga të imtat nuk ekziston si veprimtari më vete. Në të shkuarën ka pasur raste të kufizuara për majmërimin e qengjave dhe kecape; disa fermerë blinin qengja dhe keca nga fermerë të tjerë dhe i kullosnin për majmërim, si veprimtari më vete.

Disa pulari të mëdha (Driza, Tik-Tik, Chicken Farm, Zoo Farm) kanë bërë investime të mëdha në mjedise dhe veçanërisht në thertore bashkëkohore. Investimi më modern është bërë në industrinë e përpunimit të mishit. Kompani të mëdha të përpunimit të mishit, si EHW, KMY, Kazazi, Kimca, Fix, Tona kanë bërë investime të konsiderueshme në përpunimin e mishit. Disa prej tyre (KMY, Kazazi, Tona, Kimca) kanë ngritur gjithashtu thertore bashkëkohore.

Investimet në bujqësinë e mbështetur në marrëdhënie kontraktuale duket se janë një investim interesant në sektorin e pularisë. Pulari të mëdha (për shembull, Driza) furnizojnë fermerët me zogj dhe pastaj u blejnë sërish produktin përfundimtar. Disa nga këta fermerë kanë investuar në pulari të vogla por mjaft bashkëkohore.

Nevojat e financimit për investime

Duke u mbështetur në strategjinë bazuar në analizën SWOT dhe tendencat e investimeve, nevojat e financimit për investime janë përmbledhur në tabelën 25.

Përmirësimi i efikasitetit kërkon investime për përmirësimin e racave të bagëtive (gjedhë, të dhirta, të leshta dhe derra) duke importuar kafshë të gjalla ose duke blerë raca të përmirësuara të kafshëve brenda vendit – investime të konsiderueshme për përmirësimin e racës, veçanërisht të gjedhët, janë bërë gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri, kështu që raca të përmirësuara të kafshëve mund të gjenden brenda vendit. Por vetëm përmirësimi i racës mund të mos sjellë rezultate nëse nuk shoqërohet paralelisht me përmirësimin e kushteve në stallë (strehim) dhe ushqimit të kafshëve. Ndaj, mbështetja për investime në strehimin e kafshëve dhe prodhimin e ushqimit përbën gjithashtu mundësi interesante për financim.

Vlerësimet e ekspertëve tregojnë se nuk ka shumë nevojë për investime për thertore të reja, por plotësimi i teknologjisë në thertoret ekzistuese paraqet një mundësi për financim. Edhe thertoret e lëvizshme mund të merren në konsideratë për mbështetje. Gjithashtu, duke parë se në disa zona mungojnë thertoret, lind nevoja për të mbështetur investimet në rinovimin e mjediseve dhe përmirësimin e një sërë pikave të thërjes, në mënyrë që ato të plotësojnë standardet e kërkuara

të sigurisë ushqimore. Investimi në licencimin e thertoreve mund të jetë fitimprurës nëse qeveria arrin të vërë në zbatim legjislacionin aktual për sigurinë ushqimore – duke mos lejuar thertjet në vende të tjera përveç thertoreve që përmbushin standardet e kërkuara.

Tabela 25: Nevojat e financimit për investime

Lloji i investimit	Fermerët	Thertoret	Përpunuesit
1. Mbështetje për blerjen e kafshëve të racave të përmirësuara (gjedhë, të imta dhe derra)			
2. Ndërtimi/zgjerimi/modernizimi i stallave të kafshëve			
3. Përmirësimi i ushqimit të kafshëve duke mbështetur mekanikën bujqësore ujitjen dhe farat e certifikuar			
4. Ndërtimi dhe/ose rinovimi i ndërtesave të magazinimit të ushqimit për kafshët			
5. Pajisjet e transportit të kafshëve në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian për mirëqenien e kafshëve			
6. Rinovimi dhe plotësimi me teknologji i thertoreve			
7. Rinovimi, pajisjet për pikat e thertjes në zona ku nuk ka thertore			
8. Modernizimi i ndërmarrjeve të përpunimit të mishit, veçanërisht për përpunuesit e vegjël			
9. Mbështetja për investime për biznese të bazuara në marrëdhënie kontraktuale në sektorin e pularisë			
10. Pajisjet e ruajtjes frigoriferike dhe mjeteve frigoriferike të transportit të mishit dhe produkteve të mishit			
11. Investime për trajtimin e mbetjeve (plehut organik) në nivel ferme dhe përpunimi			

Investimet për biznese bazuar në marrëdhënie kontraktuale në sektorin e pularisë përbëjnë një mundësi të rëndësishme që duhet eksploruar. Institucionet financiare, kombinuar me mbështetjen nga qeveria, mund të investojnë në ndërtimin ose rinovimin e ndërtesave ekzistuese që mund të përdoren për mbarështimin e pulave për prodhim mishi - pularitë e mëdha të pajisura me thertore bashkëkohore mund t'u ofrojnë atyre zogjtë dhe ushqimin dhe të blejnë produktin përfundimtar (për më shumë hollësi referojuni financimit të zinxhirit të vlerës). Ndërkohë që për momentin diçka e tillë nuk ndodh në Shqipëri, përvoja e vendeve të tjera (përfshirë SHBA-në) na sugjeron se modeli i organizimit i mbështetur në marrëdhënie kontraktuale në sektorin e pularisë mund të përbëjë një mundësi shumë të madhe¹¹.

Mundësi të tjera në lidhje me financimin janë: ndërtimi dhe/ose rinovimi i objekteve për ruajtjen e ushqimit të kafshëve, financimi për pajisjet e transportit të kafshëve të pajtueshme me standardet e Bashkimit Evropian për mirëqenien e kafshëve, modernizimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve të vogla

¹¹ Kompania "Tyson" në SHBA përpunon 25 milion shpendë në ditë pa pasur fare pulari, sipas intervistave me ekspertët.

përpunuese të mishit, pajisjet e ruajtjes frigoriferike dhe mjetet frigoriferike të transportit të karkasës dhe produkteve të mishit, investimet për trajtimin e mbetjeve në nivel ferme dhe përpunimi.

Skemat kombëtare dhe programi IPARD II ofrojnë një mundësi për investime të reja dhe përkatësisht për kredi të reja. Konkretisht, mund të ekzistojë një nevojë afatgjatë për bashkë investim të pjesshëm (p.sh. rreth 50%, por mund të ndryshojë në varësi të llojit të skemës) dhe për grant të pjesshëm (subvencion afatshkurtër, duke marrë në konsideratë se rimbursimi në mënyrë tipike bëhet pas kryerjes së investimit).

Kutia 2: Skemat publike të mbështetjes për bujqësinë shqiptare.

Ka dy skema kryesore publike të mbështetjes për bujqësinë shqiptare, përkatësisht Skemat Kombëtare të Mbështetjes (SKM) që jepen çdo vit dhe mbështetja nga BE, si Programi për Zhvillimin Rural, IPARD. Ndërkohë që ky i fundit synon të rrisë konkurrueshmërinë dhe të zbatojë standardet e BE-së (siguria, cilësia dhe mjedisi) dhe synon bizneset më konkurruese, SKM ka politika me shumë objektiva dhe një shtrirje më të gjerë.

Objektivat dhe masat për SKM 2018 janë përmbledhur në vijim:

- Rritja e konkurrueshmërisë duke ofruar mbështetje për investime (investime në agro-përpunim dhe marketing), mbështetja e teknologjive të inovacionit dhe certifikimit dhe siguracionit
- Përmirësimi i sigurisë ushqimore duke mbështetur investimet në përmirësimin e sigurisë së zinxhirit ushqimor të produkteve blegtorale; dhe masa të tjera për rritjen e sigurisë ushqimore, si p.sh. identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve, mbështetja për sistemet e dorëzimit të sigurt të qumështit, ruajtjes dhe transportit të sigurt të qumështit dhe të ngjashme.
- Formalizimi vertikal dhe horizontal dhe formalizimi i biznesit
- Diversifikimi i veprimtarive rurale.

Ndërkohë që SKM-të tradicionalisht kanë ofruar mbështetje për të përmbushur disa objektiva atë politikës, duke përfshirë rritjen e konkurrencës, kohët e fundit është shtuar vëmendja për arritjen e standardeve të sigurisë së ushqimit, cilësisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Skemat kombëtare të subvencionimit tradicionalisht kanë ndryshuar nga viti në vit (shpesh në mënyrë drastike). Buxheti i alokuar për SKM 2018 është 20 milion euro. Për mbështetjen për investime është e vlefshme edhe skema e ngjashme e politikave të granteve të pjesshme (të paktën 50% mbështetje publike).

Një program tjetër i rëndësishëm është programi i BE-së, IPARD - Programi i Masave për Zhvillimin Rural, i cili mundëson mbështetje për investime që synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe përmbushjen e standardeve kombëtare dhe të BE-së nëpërmjet investimeve të bashkëfinancuara nëpërmjet një granti (p.sh. 50%, megjithatë vlera e saktë varet nga një sërë kriteresh). Për këtë program është miratuar një buxhet në formë granti prej 71 milionë euro nga KE dhe 24 milionë euro nga qeveria shqiptare (75% BE: 25% qeveria shqiptare), kështu që është i disponueshëm një grant për investime prej 94 milionë euro në nivel ferme dhe nivel përpunuesish përgjatë periudhës 2014-2020.

6.2.2. Nevojat për financime për kapital qarkullues

Tendencat e financimeve për kapital qarkullues

Rrallë ndodh që prodhimi i mishit të gjedhit dhe të imta të jetë një veprimtari e ndarë - qumështi dhe mishi prodhohen bashkë në të njëjtat njësi prodhimi. Kështu që problemi i likuiditetit të fabrikës së përpunimit të qumështit - procesi teknologjik i prodhimit të djathit rezulton në stoqe dhe për pasjoë në pagesa të vonuara; kjo ndikon gjithashtu edhe në prodhimin e mishit.

Nevojat për financime për kapital qarkullues

Kur fermerët shesin qumështin, paratë që marrin përdoren për të mbështetur prodhimin e qumështit dhe të mishit. Të gjitha fabrika e përpunimit të qumështit kanë probleme me likuiditetin

që lidhen me procesin e teknologjisë së djathit (referojuni studimit për qumështin). Siç tregohet më lart, mospërputhja mes shpenzimeve (që zakonisht shtrihen përgjatë gjithë vitit) dhe të ardhurave (p.sh. në kohën kur shiten viçat, qengjat ose kecat, si edhe marrja e parave nga shitja e qumështit) mund të paraqesë një mundësi për kredi afatshkurtra. Duke qenë se pagesat për mishin e freskët që u shitet shitësve me pakicë bëhen zakonisht me para në dorë ose fermerët e marrin pagesën e tyre në dorëzimin e produktit, nevoja për financim nuk është e madhe (nuk ka pagesa të mëvonshme). Nga ana tjetër, duke qenë se pagesat e mëvonshme janë të zakonshme për shitjet që pularitë u bëjnë dyqaneve të mëdha, ekziston nevoja për financim afatshkurtër.

6.2.3. Financimi i zinxhirit të vlerës

Vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve të mëdha të pularisë (mundësisht me më të mëdhenjtë, por jo vetëm) dhe fermerëve të interesuar në rritjen e pulave mund të përbëjë një mundësi të rëndësishme për financim. Marrëdhënia pulari-fermer mund të zhvillohet në dy skenarë ose kombinime të tyre.

Skenari i parë (pularia siguron shpendët dhe ushqimin për fermerët): pularia u jep fermerëve zogjtë, teknologjinë për rritjen e pulave dhe ushqimin. Fermerët zotohen se do të rrisin pulat dhe do t'ia shesin sërish pularisë me çmimin e tregut. Në këtë rast, ekziston nevoja për ndërtimin e kapanoneve, të cilat në disa raste mund të ekzistojnë dhe duhen rinovuar, dhe në raste të tjera duhet të ndërtohen nga fillimi. Kapanonet e çmontueshme mund të merren në konsideratë për financim. Duke qenë se kjo lloj strehe është e çmontueshme, nuk është nevoja për leje ndërtimi. Këto lloje kapanonesh mund të strehojnë rreth 10 000 shpendë dhe fermerët mund të kryejnë 3 cikle në vit.

Skenari i dytë (fermerët prodhojnë ushqimin): pularia u jep fermerëve zogjtë, teknologjinë për rritjen e zogjve dhe i ndihmon ata për prodhimin e ushqimit (misrit) - u jep fermerëve farë misri me rendiment të lartë prodhimi, parapagesë në cash për operacionet me makineri bujqësore (të cilat përbëjnë një shqetësim për fermerët, veçanërisht me rritjen e çmimit të naftës), i ndihmon ata për ujitjen e të tjera, dhe në fund u blen produktin përfundimtar. Fermerët marrin përsipër të rrisin pulat dhe t'ia shesin sërish pularisë me çmimin e tregut.

Në të dy skenarët ose kombinimet e tyre, marrëdhënia pulari-fermer duhet të ketë formën e bujqësisë e mbështetur në marrëdhënie kontraktuale.

Kjo lloj marrëdhënieje përbën mundësi financimi për institucionet financiare sipas mënyrave të mëposhtme: (i) mbështetje e nevojës për likuiditet nga pularitë e mëdha (ii) mbështetje për investime në ndërtimin e kapanoneve për strehimin e pulave në nivel fermeri.

Kjo marrëdhënie pune ndërmjet pularive, fermerëve dhe institucioneve financiare bazohet në interesin reciprok - pularitë shfrytëzojnë më mirë thertoret e tyre që aktualisht shfrytëzohen vetëm pjesërisht, fermerët përdorin burimet e tyre të papërdorura (tokë, forcë punëtore dhe ndërtesa) dhe institucionet financiare gjejnë një mundësi për financim.

7. PËRFUNDIME

Që në fillim të viteve 2000, prodhimi i mishit ka pësuar rritje. Ndërkohë që numri i gjedhëve dhe të imtave ka rënë, prodhimi i mishit është rritur si rezultat i investimeve në përmirësimin e racave dhe të menaxhimit (ky i fundit është tipik për fermat e mëdha numri i të cilave është në rritje). Në rastin e shpendëve, prodhimi i brojlerave është katërfishuar gjatë së njëjtës periudhë. Në përgjithësi, prodhimi i mishit ka si destinacion tregun e brendshëm, kështu që rritja e prodhimit është e nxitur kryesisht nga rritja e kërkesës vendase. Megjithatë, bilanci tregtar i mishit tregon një deficit strukturor. Rreth 1/3 e kërkesës së brendshme plotësohet ende nga importet (të cilat janë në formën e kafshëve të gjalla dhe mishit të ngrirë) – kështu që çdo investim ose zhvillim biznesi duhet të marrë në konsideratë kontekstin e zëvendësimit të importeve dhe jo kontekstin e eksportit (i cili nuk ka gjasa të jetë i rëndësishëm, të paktën në të ardhmen e afërt).

Sektori i karakterizohet nga një dualizëm i theksuar: industria e përpunimit është mjaft bashkëkohore dhe ka një model biznesi i cili deri më tani ka funksionuar mirë, ndërsa prodhimi i mishit (përveç mishit të pulës) është ende tejet i fragmentizuar dhe, çka është më e rëndësishme, siguria e produkteve të freskëta që shiten me pakicë nuk është gjithnjë e garantuar, duke qenë se ende nuk është mundur të ngrihet një rrjet thertoresh që përmbushin standardet minimale.

Në nivelin e prodhimit parësor, shumica e fermave të mbarështimit të gjedhëve, deleve dhe derrave janë të vogla ose shumë të vogla. Ndryshe nga këto, mbarështimi i shpendëve me orientim tregu është i zhvilluar mirë me më shumë se një duzinë njësisish me mbi 10 000 brojlere. Shumica e ushqimit për kafshët importohet dhe përpunohet në Shqipëri. Për shkak të importit të lëndës së parë, kostoja e prodhimit është e lartë. Në rastin e pularive, edhe zogjtë e vegjël importohen.

Industria e mishit ka qenë sektori i parë agroindustrial që u konsolidua dhe u zhvillua. Industria është e fokusuar në tregun e brendshëm ku ka treguar se është konkurruese. Qëndrueshmëria e saj bazohet në importimin e mishit të ngrirë me çmim të lirë, i cili garantohet nga pak importues të mëdhenj, të cilët kanë kapital të mjaftueshëm dhe janë të mirëorganizuar.

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e sektorit të mishit për mundësitë kryesore për të financuar këtë sektor. Disa nga mundësitë më të mira për financim janë investimet për blerjen e kafshëve të racave të përmirësuar (gjedhë, të dhirta, të leshta dhe derra), përmirësimin e kushteve të stallave (strehimit) dhe përmirësimin e të ushqyerit të kafshëve. Ndonëse investimi për thertore të reja nuk është shumë i nevojshëm, plotësimi i teknologjisë në thertoret ekzistuese përbën një mundësi për financim. Edhe thertoret e lëvizshme mund të merren në konsideratë për mbështetje. Përmirësimi i një sërë pikash therjeje në mënyrë që ato të përmbushin standardet e sigurisë ushqimore mund të jetë gjithashtu një fushë interesante në rajonet/basketë ku ka një mangësi thertoresh të licencuara. Mundësi të tjera në lidhje me financimin janë ndërtimi dhe/ose rinovimi i objekteve për ruajtjen e ushqimit të kafshëve, financim për pajisjet e transportit të kafshëve të pajtueshme me standardet e Bashkimit Evropian për mirëqenien e kafshëve, përmirësimi i teknologjisë në ndërmarrjet e vogla aktuale të përpunimit të mishit, pajisjet e ruajtjes frigoriferike dhe mjetet frigoriferike të transportit të mishit dhe produkteve të mishit, investimet për trajtimin e mbetjeve në nivel ferme dhe përpunimi.

Investimet në bizneset që pritet të zhvillojnë marrëdhënie kontraktuale në sektorin e pularisë përbëjnë një mundësi të rëndësishme që duhet shfrytëzuar - ndërtimi ose rinovimi i ndërtesave

ekzistuese që mund të përdoren për mbarështimin e pulave për prodhimin e mishit ose mbështetja për kapanone të çmontueshme për pulat.

Sektori i mishit konsiderohet si sektor me përparësi për qeverinë shqiptare. Politika aktuale e granteve të pjesshme ka implikime të rëndësishme për institucionet financiare - ato kanë mundësinë për të bashkëfinancuar investimet (stallat, zinxhiri i ftohjes, përpunimi i qumështit etj.) e 100% të shumës, nga e cila 50% mund të jetë kredi afatshkurtër (pjesa që duhet të rimbursohet nga granti pas kryerjes së investimit) dhe 50% kredi afatgjatë për pjesën që duhet të paguhet nga përfituesi.

Institucionet financiare duhet të marrin në konsideratë (i) zhvillimet në zbatimin e standardeve të sigurisë (i cili është një kusht paraprak për investimet e reja në sektorin e blegtorisë) dhe (ii) shfrytëzimin e bashkëfinancimit për investime: financimi nga banka i kombinuar me mbështetjen financiare publike nëpërmjet skemave mbështetëse të qeverisë shqiptare ose skemave të IPARD.

8. BIBLIOGRAFIA

EC (2017). EU Agricultural Outlook for the Agricultural Markets and Income 2017-2030

Eurostat (2018). <http://ec.europa.eu/eurostat>

FAOSTAT (2018). Database available at <http://www.fao.org/faostat/en/>?

FAO (2014). Meat Sector Study

Gjeci, G., Bicoku, Y., & Imami, D., (2016). Awareness about food safety and animal health standards – the case of dairy cattle in Albania. *Bulgarian Journal of Agricultural Science*, 22(2), 339–345.

Imami, D., Chan-Halbrendt, C., Zhang, Q., & Zhllima, E. (2011). Conjoint analysis of consumer preferences for lamb meat in central and southwest urban Albania. *International Food and Agribusiness Management Review*, 14(3).

Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., Cela, A., & Sokoli, O. (2015). Consumer preferences for typical local products in Albania. *Economia agro-alimentare*.

INSTAT (2017). Baza e të dhënave gjendet në www.instat.gov.al

Verçuni, A., Zhllima, E., Imami, D., Bijo, B., Hamiti, X., & Bicoku, Y. (2016). Analysis of consumer awareness and perceptions about food safety in Tirana, Albania. *Albanian Journal of Agricultural Sciences*, 15(1), 19.

Zhllima, E., Imami, D., & Merkaj, E. (2012). Food consumer trends in post socialist countries: the case of Albania. *Economia agro-alimentare*.

Zhllima, E., Imami, D., & Canavari, M. (2015). Consumer perceptions of food safety risk: Evidence from a segmentation study in Albania. *Journal of Integrative Agriculture*, 14(6), 1142-1152.

UNSTAT (2018). Baza e të dhënave për tregtinë <https://comtrade.un.org/data/>

